

INTERVISTË ME SHYQYRI SADIKUN

Stantërg | Data: 29 tetor, 2020

Kohëzgjatja: 166 minuta

Të pranishëm:

1. Shyqyri Sadiku (I intervistuari)
2. Anita Susuri (Intervistuesja)
3. Korab Krasniqi (Intervistuesi)
4. Renea Begolli (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: Zoti Shyqyri, nëse mundeni me u prezantu edhe me na tregu diçka për familjën?

Shyqyri Sadiku: Po, faleminderit. Unë quhem Shyqyri Sadiku, jam i lindur më 22.07.1963 në fshatin Bare, komuna e Mitrovicës. Realisht jetoj në një familje, po flas, një jetë mesatare tash. Periudha ime si fëmijë, kom lindë në fashtin Bare. Ndoshta hapat e parë t'shkollimit i kom fillu n'vitin 1969, në fshatin Bare ku ka qenë edhe shkolla fillore. Deri në klasën e shtatë i kom kry studimet ose shkollën fillore në Bare. Në vitin 1976 jemi shpërngulë në qytetin e Vushtrrisë, realisht atje shkollën fillore e kom mbaru. Pas mbarimit t'shkollës fillore kom fillu shkollën e mesme, ku jom regjistru n'shkollën e mesme teknike në Mitrovicë, dhe e kom kry edhe shkollën e mesme në Mitrovicë.

Na rrjedhim prej një familje, po flas edhe në fshat kena jetu ma shumë prej blegtorisë edhe punëve të tjera po flas. Realisht, po flas prindërit edhe t'parët tonë kanë fillu nashta hapat e parë me minierën e Stantërgut që e kanë pasë afër këtu në minierë, që fatbardhësisht kjo pasuri që na ka dhuru Zoti duhet të dijmë ta shfrytëzojmë edhe ta ruajmë. Hapat e parë n'këtë minierë i ka bo gjyshja im i ndjerë, i cili ka qenë i lindur diku 1910 dhe hapat e parë i ka fillu në minierë, t'punoj në minierën e Stantërgut në vitet 1935-6, n'atë kohë ka fillu edhe Lufta e Dytë Botërore.

Tash të flas për kushtet e tyne të vështira, tash po flas atë që ma kanë tregu prindërit e mi edhe gjyshja ime. Ka qenë një jetë e vështirë, një jetë shumë e randë me vështirësi t'mdhaja. Gjendjen ekonomike e kanë pasë, n'përgjithësi po flas, e kanë pasë shumë t'ranë. I ka mungu infrastruktura, të gjitha ju kanë mungu realisht, edhe punën e kanë bo, gjithmonë levizjen e kanë bo n'kamë. Tash i ka dikun nontë kilometra nga Stantërgu në fshatin Bare, gjithmonë kanë lëvizë n'kamë edhe kanë punu në sistemin, po flas, brigador, kanë punu n'ndërrim t'parë, t'dytë edhe t'tretë.

Tash jonë edhe pak t'dhimbshme ato kushte me i spjegu një histori të tillë që atëherë ushqimin e kanë bartë edhe prej shpije, atëherë ka pasë mungesë edhe t'ushqimit, po flas. Një kohë jonë ushqy me elb,

realisht, nuk ka pasë grurë. Mas një kohe tani u ardhë edhe misri që e kanë përdorë, me misër. Edhe punën që e kanë bo, edhe jonë ardhë kanë punu në minierë, bukën e kanë marrë prej shpije. Edhe thuhet gjithmonë kanë marrë bukë t'kallamojt që nashta dhe me t'vërtetë ka pasë mungesa edhe t'gjitha gjërave tjera. Nashta shumë herë e kanë marrë veç bukën, pa ushqimet e tjera përcjellëse ose naj qumshtë që kanë pasë.

Atëhere, Trepçën n'atë kohë, po flas viteti 1924, hulumtimet e para i kanë fillu anglezët, po. Edhe vitet 1927 kanë fillu punimet e para në minierë, ku n'vitin 1930 ka fillu prodhimi testues, që ka qenë prodhimi ditor 500 ton. Metoda ka qenë e shfrytëzimit, metoda klasike, jonë kanë metoda shumë t'rana që ka pasë edhe shumë fatkeqësi, që kanë hupë shumë njerëz. Na i kem edhe statistikat, vitet dikun '48, '49, '50 që brenda vitit kanë hupë jetën deri në dymdhetë vetë n'minierë. Për shkak që siguria nuk ka qenë n'nivel dhe kushtet kanë qenë shumë t'vështira n'punë.

Tash periudha e babgjyshit ka qenë ajo që ka punu, ka punu domethanë deri n'vitet, diku vitet e '50-ta. Vitet e '50-ta ju ka dhanë rasti edhe e ka lëshu punën për shkak t'kushteve t'vështira edhe puna që ka qenë e ranë në minierë, nuk ka pasë kushte mikro-klimatike po flas, ajrimi ka qenë i dobët. Puna osht' bo krejt fizik, ngarkimi osht' ba me anën e lopatave në vagoneta. Vagonetat jonë shty me dorë edhe këto kanë qenë probleme të tilla që nashta e kanë detyru me lëshu punën se s'ka mujtë me përballue gjithë atë punë t'vshtirë që ka qenë edhe gjithë ato kushte t'rana që kanë qenë.

Anita Susuri: Ju m'tregut që babgjyshin si e kanë detyru njifarë forme me punu se ai s'ka dashtë...

Shyqyri Sadiku: Realisht, po...

Anita Susuri: Qysh...

Shyqyri Sadiku: Tash po flas... po, ajo ka qenë periudha e okupimit e Luftës të Dytë Botërore që i kanë detyru me ardhë me punu në minierë. Ka qenë luftë, edhe realisht nuk i kanë pytë shumë, edhe jonë kanë të detyruar të punojnë edhe kanë punu për atë periudhë. Po flas, unë po flas prapë, rasti i parë që ju ka dhanë mas lufte, diku vitet '50, që ju ka dhanë rasti i parë e kanë lëshu punën për arsye të tilla që i potencova ma herët, për shkak të kushteve t'rana, t'vështira. Po flas edhe, edhe lëvizja që ka qenë e gjatë, po mendoj, prej fshatit Bare, që ka pasë edhe fshatra tjerë edhe ma larg që kanë lëvizë n'kamë tonë kohën edhe domethanë ka qenë me t'vërtetë vështirë. Edhe ju ka dhanë rasti edhe e ka lëshu realisht punën edhe ju ka kthy blegtorisë edhe punëve të tjera që kanë qenë n'fshat.

Anita Susuri: A i kanë detyru gjermanët me punu, a kush?

Shyqyri Sadiku: Po realisht i ka detyru n'atë kohë, ose u duftë me shku në, në ushtri të tillë ose u duftë me punu në Trepçë. Na t'drejtën me t'thanë kemi qenë edhe një familje e përndjekne politikisht atëhere prej sistemit komunist. Babgjyshi jem e ka pasë motrën t'martume për Ahmeti Selacin. Edhe

realisht jena kanë t'përndjekur tonë kohën, po flas për periudhën mas luftime, kur osht' hy partizan, atëherë komunistë, domethanë jemi kanë t'përndjekur nga ta. Edhe nashta edhe ajo ka qenë një formë që e ka detyru babgjyshin edhe ta lëshoj punën, presione të tilla s'ka mujtë me i përballu se është qujtë si familje e ballistave.

Anita Susuri: A keni qenë, po mendoj familja juje a ka qenë qasi lëvizje?

Shyqyri Sadiku: Ka qenë, po, ka qenë. Babgjyshi ka qenë në lëvizje me gjithë vëllaun e vet, se jena kanë edhe miq tash realisht me Ahmet Selacin. Edhe i ka kushtu, drejtë me thanë, ai ka qenë edhe i burgosur. Ka qenë i burgosur politik, po flas, mas luftës, si ballist i qujtun në Lëvizjen Nacional-Çlirimtare që ka qenë, ballista që i kanë qujtë. Edhe ka qenë i presekutimë, ka qenë i dënum edhe me vite burg. I ka kalu ato vite burg edhe realisht pas përfundimit t'burgut ju ka kthyer blegtorisë.

[Video-intervista ndërpritet]

Anita Susuri: ... tregut për historitë gjyshja që ju ka tregu.

Shyqyri Sadiku: Po, historinë drejtën me t'thanë pas, gjatë luftës dhe pas luftës ma tepër na ka spjeguar histori gjyshja, e ndjera. Ajo na ka tregu qysh kanë qenë të përndjekur familja jonë, për shkak t'përcaktimeve që i keni pasë atëherë, edhe ka qenë me t'vërtetë vështirë që s'di sa herë... e keni pasë kullën atëherë, kullën e ndërtuar prej gurit, që osht' rrethekur s'di sa here për me nxënë babgjyshin edhe vllaun e tij me i ekzekutu. Fatbardhësisht, gjithmonë ka pasë njerëz të tillë t'mirë që i kanë informu edhe realisht gjithmonë jonë ikë.

Po flas në një rast që ka ikë, kallzoi gjyshja. Realisht, në një rast kur kanë ikë dathur, zbathur kanë ikë, u kanë kohë e dimrit që kanë ikë edhe babgjyshi edhe vllau i tij. Jonë shku në drejtim të Selacit, ku i keni pasë do kusheri atje tu jetu edhe atje jonë strehu n'qat periudhë. Domethanë, nuk osht' hera parë, kanë qenë një tri here që kanë tentu me i ekzekutu babgjyshin edhe vllaun e tij për shkak...

Anita Susuri: Partizanët...

Shyqyri Sadiku: Po, partizanët. Për shkak të përcaktimit që keni qenë t'lidhun me Ballin Kombëtar, n'këtë rast me ballistë.

Anita Susuri: E deri kur ka ndodhë qishtu?

Shyqyri Sadiku: Kjo ka zgjatë deri n'periudhën, nashta deri vitet '55, po flas, që kanë qenë në nifare forme t'mbikqyrur. Po neve periudha na ka ndodhë gjithmonë edhe në ish sistemin Jugosllav. Jena kanë të mbikqyrur realisht prej sistemit, prej komunistave që me vështirësi e keni pasë edhe na, edhe

shkollimin, edhe punësimin. Edhe domethanë kena qenë si familje domethanë të mbikqyrur nga ish sistemi se gjithmonë ata kanë mbajtur evidenca kush ka qenë në grupe të tilla, në Ballin Kombëtar.

Unë po flas tash për periudhën e babgjyshit, që ni histori drejtën me t'-thanë nashta edhe punët e vështira, edhe sakrificat që i ka bo... edhe ai ka vdekë në ni moshë shumë t're, n'moshën 55 vjeçare ka vdekë. Realisht kanë qenë t'gjitha këto ndikime, që kanë qenë presionet, burgimet, domethanë përndjekjet, edhe u shku në ni moshë t're. Drejtën me t'-thanë i ka lanë fmitë në ni moshë t're, po flas. Po këta fmitë e babgjyshit, tash po flas për prindët edhe mixhallarët e mij jonë rritë me mixhën, me mixhën e vet që ka qenë domethanë vllau i babgjyshit. Edhe ai ka qenë i përndjekur realisht. Edhe ata jonë rritë me mixhën, po flas periudhën që fola, vitet 1976.

Anita Susuri: N'kullë keni jetu a?

Shyqyri Sadiku: N'kullë kena jetu si familje e përbashkët. Kena qenë 33 anëtarë që kena jetu n'atë familje, kemi qenë familje e gjerë që kemi jetu bashkarisht n'kullë. Edhe shkollimi jonë ka qenë i vështirë po flas, edhe ka qenë skamje po flas, n'atë aspektin që ka pasë mungesë t'gjithave. Edhe mungesë të librave, edhe mungesë t'gjërave ushqimore, edhe të veshmbathjës edhe ka qenë shumë vështirë realisht. Po flas, një histori që tash me i kallzu diku i dokët një histori që shumë e kapshme osht', qe me t'vërtetë atëhere nuk i kena pasë gjanat elementare me shku n'shkollë. S'kena pasë lapsa, s'kena pasë fletore. Kena pasë mungesë t'gjithçkafit.

Po krenohem me ata arsimtarë n'kohë t'vështira që na kanë eduku, na kanë mësu n'këtë formë, domethanë ka pasë të tillë që na kanë spjegu edhe për çështjen kombëtar. Po gjithmonë kanë qenë nashta gjana pak ma sekrete që i kanë spjegu.

Anita Susuri: Deshta me ju pytë për si fëmijë qysh ka qenë me u rritë në kullë? Qysh e kujtoni, çka ju bjen n'mend tash për shembull prej atëhere si fëmijë?

Shyqyri Sadiku: Po m'bjen shumë n'men, s'pakti m'bjen n'men spjegimet që na i ka lanë gjyshja. Qysh jena rritë si fëmijë t'vogël, atëhere me t'vërtete kushtet kanë qenë t'jashtëzakonshme. Mrena në kullë, njonën anë kanë qenë të ngjuara. I kena pasë, po flas, knena ka qenë shpija, knena kanë qenë lopët e ngujume, dhet', domethanë të tjera që jonë kanë krejt mrena në kullë. Ka qenë jetë me t'vërtetë e vështirë, atëhere ballafaqimet, tash t'jetojsh n'atë kohë në një shpi të tillë, sot me ja spjegu diku osht' e pakapshme. Po na i kena përjetu ato, ato, ato...

Anita Susuri: Qysh u dokë ajo kulla?

Shyqyri Sadiku: Kulla ka qenë dy katshe, ka qenë shumë e bukur, ka qenë e murosur, krejt e punume me guri, krejt realisht. Sikur tash kullat qe i kanë dekoru, identike ka qenë kullë. Kanë qenë, punimet e dritareve kanë qenë shumë t'vogla për shkak se kanë qenë t'përgaditne për luftra të tilla. Jonë kanë

t'vëndosne edhe trëngjitë që janë kanë për lufta. E ka pasë derën kulla shumë t'sigurime edhe për luftë, e ka pasë atë shulin mrapa dera që e ka mbyllë edhe shumë vështirë u kanë për me hapë. Jonë kanë t'përgadita, domethanë kullat janë kanë t'përgadita për lufta të tilla atëherë që janë kanë.

Osht' ni jetë tash drejtën me t'thanë... tash kati i dytë u kanë, po n'katin e dytë kur je hypë prapë ke pasë ni derë mbyllëse, që e ke mbyllë katin e dytë që me siguru edhe katin e dytë realisht, që nëse depërtojnë n'katin e parë, që n'katin e dytë mos me mujtë me depërtu. T'gjitha këto janë kanë për shkak t'represionit që kanë pasë shqiptarët n'kohën që janë kanë t'përgaditë për lufta t'tilla. Mu m'ka lanë përshypje ni histori t'tillë me kthy mrapa, drejtën me t'thanë, m'kujtohen shumë mirë jetët e tilla edhe ato sfidat që i kena kalu, si fëmijë po flas. Po spjegimet gjithmonë i kena marrë prej prindërve edhe prej gjyshës, prej nanave që na i kanë spjegu problemet e tilla. Po pak i kena përjetu edhe na, po flas. Çka kanë përjetu ata, n'krahësim me ta na kena përjetu shumë ma lehtë kena kalu, po flas edhe për kah gjendja ekonomike edhe të tjera.

Po, edhe unë i përjetoj do jeta t'vështira që realisht... na dej vonë, dej vitet nashta '70-ta s'kena pasë gru, domethanë jena ushqy me misër, jena ushqy me elb. Ato i kanë përgaditë nanat tona, mullijtë i kena pasë. Mullijtë kanë qenë mullij që kanë punu me ujë. Kane qenë mullij natyral, me gurë...

Anita Susuri: A keni pasë ju mulli personal apo...

Shyqyri Sadiku: Po, po. E kena pasë mullinin personal, e kena pasë n'tokë tonë, n'pronë tonë edhe aty e kena blu misrin, e kena blu elbin për me ju kriju ushqim familjeve.

Korab Krasniqi: Ka qenë mulli me ujë apo...

Shyqyri Sadiku: Me ujë, me ujë.

Korab Krasniqi: A mundësh me na kallzu qysh osht' organizu jeta mrena kullës?

Shyqyri Sadiku: Po jeta mrena kullës ka qenë një bashkësi familjare, une e potencova, 33 anëtarë kena jetu n'bashkësi familjare. Tregova poshtë e kemi pasë shpinë që ka qenë si shtëpi që kena nejt aty realisht, jena ushqy aty. Fjetjën edhe dhomën e pritjës e kena pasë naltë n'katën e dytë. Edhe t'gjithë jeta u zhvillu e tillë mrena për mrena kullës. Po gjithmonë....

Anita Susuri: M'fal që po t'ndërprej, deshta me t'pytë a ka pasë naj derë apo kapixhik anësore për me mujtë me ikë?

Shyqyri Sadiku: Ka pasë n'katin e dytë mrapa, po. E qata që t'tregova, babgjyshi me atë vllaun e vet kanë ikë prej qasaj dere, që janë ikë zbathur domethanë dimrit kanë shku deri gati në Selac n'kamë, qajo e ka shpëtu, qajo derë. E ka pasë derën mrapa për çdo rast, nifarë forme me ikë. Po e ka pasë

derën realisht. Po jeta e tillë u kanë n'kullë domethanë, aty jena ushqy, edhe lopët n'këtë rast, edhe i kena pasë delet, që pak ma vonë kena fillu me investu e i kena bo edhe shtallat jashtë kullës. Që i kena marrë po flas gjenerata ma vone që ka ardhë. Edhe ma s'tepërmi jena marrë me blegtori, realisht, me, me gjana të tilla.

Mos t'flas, atje kena kultivu edhe patate koxha shumë. Patate që domethanë ka qenë edhe ni, ni, ni lami që jonë merrë ata, me patate. Edhe me patate realisht jonë ardhë, patetet i kanë shitë në Mitrovicë. E kanë bo ni lloj tregtije, tash me ble gjana tjera ushqimore kanë shitë patate, për me ble gjana ushqimore të tjera.

Anita Susuri: E përmendët mullinin e ujit, kush zakonisht ka shku me blu? A keni shku edhe ju najhere, a ju kujtohet?

Shyqyri Sadiku: Po, po, m'kujtohet. Po, kom shku me babën s'di sa here. Po puna ma e vështirë me blu ka qenë dimrit realisht. Se dimri ka pasë ngrica që e ngrike, e ngrike ujët realisht që vike në mulli edhe u dufke me thy. Mu m'kujtohet si fëmijë tash, baba jem kur e thejke akllat, për me lëshu ujtë, për me blu me i kriju ushqim familjës, se me t'vërtetë ka qenë jetë e vështirë, po flas ka pasë skamje t'mdhaja.

Anita Susuri: M'tregutë që edhe baba ju ka vazhdu me punu në minierë...

Shyqyri Sadiku: Ka vazhdu babi im, realisht një kohë nuk ka mujtë për shkak që tregova edhe ma herët, që jemi kanë një familje e përndjekur realisht. Ai tek në vitin 1974 osht' punësu. Domethanë shumë vonë. Ka qenë i lindun më 1934, ju ka dhane rasti dikun n'moshën 40 vjeçare. Mas 40 vite, po flas, ka fillu nashta hapat e parë me i bo këtu në minierën e Statërgut.

Anita Susuri: E qysh ndodhi që ai u punësu, a ka pasë nevojë apo...

Shyqyri Sadiku: Gjithsesi, nevoja ka kërku prej viteve '60-ta me u punësu. Po për shkak t'përcaktimeve që i kena pasë nuk ka mujtë realisht m'u punësu. Ai u dalë ka punu edhe në Mal të Zi, edhe shumë punë tjera ka punu, po flas fizike, për me mujtë me na kriju neve t'hyra materiale, ose me mujtë me majtë familjën realisht. Kemi qenë një familje shumë e gjanë, prej 33 anëtarëve që u duftë edhe me siguru ushqim për familje t'tillë. Po flas, ka punu ni kohë edhe në Mal të Zi, ka punu punë private, realisht edhe deri n'vitin 1974 menxi ju ka dhanë rasti me hi në minierë me punu.

Anita Susuri: E në Mal të Zi, pse ka shku aq larg?

Shyqyri Sadiku: S'ka pasë punë. Mungesë e punëve ksajde edhe n'mungesë, po flas gjithmonë që i kena pasë përcaktimet, vijat nga komunizmi, nuk i kanë lanë shumë me...

Anita Susuri: Po...

Shyqyri Sadiku: Me punu realisht mrena në Kosovë edhe jonë kanë t'detyrumë me dalë jashtë Kosovës t'punojnë.

Anita Susuri: Ju pyti edhe Korabi ma herët për familjën, po po du edhe një herë mu kthy te hiarkia që u kanë, për shembull, e familjës. Qysh ka qenë edhe, e di që edhe kur jonë shtru sofrat osht' ditë kush ku po ushqehet, a ka qenë kështu edhe te ju, a qysh?

Shyqyri Sadiku: Ka qenë realisht, po. Ka qenë një hiarki që unë mburrna me atë, ka qenë ni zot shpije që gjithmonë ai osht' pytë për gjithçka. S'po thom që ka qenë krejt edhe mirë, po nuk ka qenë edhe keq. Se realisht qaj i zoti shpisë në mbramje, jena mledhë domethanë familja ka qenë domethanë të gjitha çka kena qenë mashkuj, që jena kanë të zot me punu diçka, e kena pasë takimin n'mramje që osht' majtë edhe kena marrë orar të gjithë prej zotit t'shpisë. Çdonjani i ka pasë detyrat edhe punët e caktume ne mëngjes kur i ka detyrat edhe punët e caktume me i kry.

Dikush ka pasë me shku me i lëshu delet, dikush ka pasë me i lëshu lopët, dikush ka pasë detyra të tjera me shku n'mal, dikush me shku me thurë... se atëherë jonë thurë edhe pronat ka i kena pasë tonat jonë thurë, për shkak mos me i dëmtue. Tjetri i ka pasë detyrat e tjera, me punu tokën, po realisht t'gjithë jena përcaktu për detyrat që i kemi marrë n'mramje. Gjithmonë detyrat i ka dhanë i zoti i shpisë. Edhe t'gjithë jena pajtu, me punën edhe orarin, realisht ai ka qenë një lloj orari i punës në mramje.

Sa i përket ushqimit, gjithmonë kanë qenë njerëzit që kane qenë m t'ngritun, ma t'rritun po flas në moshë e kanë pasë, po. Sofra osht' kthy edhe kanë hangër bashkarisht. Bashkarisht kanë hangër atëhere se nuk kena pasë edhe pjata, edhe enë të tilla. Nashta bashkarisht kanë hangër t'gjithë me ni pjatë. Osht' qitë, ose pasuli qe osht' qitë, atëherë zakonisht përdorë pasuli, ose patatet qe jonë zi, realisht, po kanë hangër me ni pjatë t'gjithë në mungesë t'pjatave tjera.

Edhe na, gjeneratë që kena qenë, si fëmijë po flas, edhe na e kena pasë sofrën tonë që e kena kthy, e kena hangër bashkë të gjithë. Pavarësisht sa kemi qenë n'atë moshë, përafërsisht ni moshë të tillë, kena hanger bashkë, kena hanger njejtë në ni pjatë. Gjithashtu ka qenë sofra për gjininë femrore, për nanat tona, për gratë edhe të tjera. Edhe ato e kanë pasë sofrën realisht që kanë hangër bashkarisht.

Anita Susuri: Deshta me t'thanë n'fakt që te burrat qaj ma i vjetri i ka caktu punët, a u kanë edhe te gratë ma e vjetra që i ka caktu punët?

Shyqyri Sadiku: Po, po. Po, ka qenë gjyshja. Po realisht te na ka qenë gjyshja. Gjyshja ka qenë ajo që i ka caktu punët të gjinia femrore realisht, ajo i ka dhanë. Tash e kanë pasë ni javë për shembull me gatu, realisht me përgaditë ushqimin, me gatu. Njo ka pasë ni javë me gatu, tjera me fshi, tjetra e ka

pasë me pastru plehin, me largu prej oborreve, me i fshi oborret realisht. Të tjerat kanë pasë edhe punë fushe që janë dalë. Realisht ka pasë kositje t'livadheve, korret që janë bo. Atëhere janë bo metodë klasike me drapën. Sigurisht që i dini, keni pa, t'gjitha... domethanë elbi kur osht' korre, osht' korre me drapën krejt, jone tërë, tanshi i kena lidhë.

Edhe lidhja ka qenë me thupra, thupra t'drunit domethanë, lidhëse s'kena pasë, domethanë n'mungesë të tyre... edhe tanshi i kena marrë, kur u shterrë ata i kena bo krysa ju thojshim, i palojsim n'lamë, se e kena pasë lamën të tillë. Edhe tanshi n'lamë, e kena shtru lamën u çojshin ata herët, dikun n'ora 4:00, 5:00 t'mëngjesit e shtrojsin edhe e kena bo fshirjen e lamës. Fshirjen e kena bo me kuaj. U kanë mullari aty n'lamë edhe me litar u dufke gjithë ditën me fshi, për me shkunë drithnin e elbin edhe tanshi kashtën e hiqshum.

Jonë kanë edhe nanat tona, edhe gjyshet tona edhe mashkujt që kanë punu bashkarisht. Kur u kanë lama, koha, fshirja, korra, fshirja osht' bo n'qat metodë. E kena hekë kashtën, e kena da kashtën, tanishi u metë drithni. E tanishi u duftë edhe kta me hidhë, po gjithmonë u duftë me hidhë. Kanë qenë të plota, ose, ose shosha. Në mes shoshës edhe të plotës e kanë hekë grunin naltë, po menoj elbin, se grunë s'kena pasë, elbin e kanë hedhë për me pastru me metë kokrra e pastër.

Domethanë, krejt atë pluhën, po flas nanat tona janë mlu, edhe krejt ai pluhën, domethanë tu e hedhë, ka ra mbi to. Që ka qenë ni jetë, po thom, shumë e vështirë. Gjithë kjo punë osht' bo me ju kriju t'hira ose ni ushqim me ju kriju familjës mrena për mrena.

Anita Susuri: Tash qysh ju qysh po ma përshkrini po e paramendoj që ka qenë shumë ni oborr shumë i madh se e keni pasë kullën po thoni...

Shyqyri Sadiku: Po...

Anita Susuri: Çka ka pasë tjetër në tonë atë oborr?

Shyqyri Sadiku: Ka pasë, na n'oborr e kena pasë bunarin gjithsesi për ujë. E kena pasë, atëherë ju kanë thanë qilerkë, nuk e di a e dini çka osht', që osht' vendosë bylmeti, osht' grumbullue. Qumështi, djathi, të gjitha ato domethanë kanë qenë... ato kanë qenë t'thurruna me thupra, realisht, se ajrosja me qenë ma e mirë, po. Tash po t'thom e kena pasë, ma vonë osht' ndërtu edhe ni odë. Tash oda osht' nda prej kulle, u kanë shumë larg po flas n'distancë, a u kanë tash njëqind metra që u kanë oda për pritjen e musafirëve. Ajo osht' ndërtu ma vonë, po, ka qenë tani që janë ndërtu edhe ahrie tjera, po flas n'kontekst se ahrie ju kanë thanë atëhere

Anita Susuri: Ahrije a qysh?

Shyqyri Sadiku: Po, ahrie, ahër. Ahër domethanë me i vendosë shtazët. Se atëhere ni kohë nuk kanë

pasë, veç i kanë thurrë nashta edhe i kanë lanë jashtë edhe dimnit. S'kanë pasë kushte të tilla, tash po thirrën shtalla për shtazë që po i marojnë, po edhe atëhere i kena maru. E kena pasë plemën realisht, edhe ajo plemja osht' thirrë që osht' vendosë sana, osht' vendosë kashta. Po realisht te lama u kanë që i vendosshim t'gjitha ushqimet, po flas, me i ushqy shtazët. Ka qenë kashta, ka qenë sana që e kositshum... nëpër Bare ka qenë egërsina ma tepër që e kositshum edhe e vnojshim.

Tash siguisht sana dihet qysh vnohën me mullarë, sigurisht keni pa, i bajshim prej atjehit, ka pasë ni largësi dikush dy-tri kilometra që i bajshum, i bishum n'shpi, i vnojshum n'sanë edhe tanishi për dimër i sigurojshim ushqim kafshëve. Ka qenë ajo ni histori e tillë që ajo ka qenë. Tanishi dimrit po flas, me t'vërtetë s'ka pasë, metodë klasike gjithçka u bo. U kanë pak vështirë, megjithëse kena jetu në fshat edhe i kena pasë malin afër e sene, po nuk kena pasë qerre, me i tërhekë, me i pru drutë realisht.

Shumica e sigurimit të druve për dimër osht' bo dimnit, për shkak qe jonë kanë sajat. Rake borë, atëhere borat shumë t'mdhaja rashin edhe jena kanë të detyrum dimrit me shku me i marrë drutë, me i pre n'mal, që me t'vërtetë u kanë shumë vështirë n'atë kohë. Ka qenë edhe t'lagta, edhe nuk e di sot qysh jonë dhezë edhe qysh jena nxe. Druri i njomë realisht. Edhe u kanë vështirë, po flas edhe për gjininë femërore se shumicën e rasteve gjinia femërore i kanë shkurtu vet, i kanë siguru.

Po mu m'kujtohet, si fëmijë tash po flas, kur shkojshum, si qoban po flas, n'atë aspketin që kena qenë bari, po, i kena ru delet atje. I sigurojshum nanave realisht atje, merrshum druna t'tharë nëpër male, i marrshum n'krah edhe ja u sigurojshum, ja i shkurtojshum edhe ja u përgaditshum për dimër, s'pakti për me e dhezë zjarrin. Kjo ka qenë...

Anita Susuri: Deshta me pytë qysh jeni nxe, a keni pasë asi kamini që i thojnë...

Shyqyri Sadiku: Oxhak. Oxhaku ka qenë, po. N'shpi po flas, kur e kena pasë kullën, katin e parë, qajo shpija që osht' përdorë për ushqim edhe për nej e kena pasë oxhakun si kamin qe po thu ti që jonë punu. Aty jena nxe, dikush u nxe ma shumë kush u kanë ma afër, dikush ma pak që ka qenë ma larg. Po realisht qajo ka qenë nxemja.

Anita Susuri: Veç qajo dhomë u nxe.

Shyqyri Sadiku: Po, tashti ma vonë, po flas nashti edhe kur kena fillu si gjeneratë, tash jonë maru odat, jonë kanë stufat realisht jonë qujtë. Tanishi nëpër dhoma stufat, se atë kohë s'ka pasë, po flas, nashta as stufa s'ka pasë. Kanë qenë oxhaqe të tilla qe jonë nxe n'shpi. E n'ato oxhaqe jonë kanë edhe zinxhirë të vendosën, këto vigat që e kanë vlu edhe ujtë se s'kanë pasë, shporeta nuk ka pasë n'atë kohë, s'ka pasë. Edhe ujtë për pastrim e kanë vlu qaty.

Domethonë, kjo përgaditje po flas n'metodën ma t'vështirë, ma t'ranë. Ka pasë mungesë edhe t'ujit, se ka qenë bartja e ujit shumë larg. Taneshi pastrimi ka qenë me vështirësi shumë t'mdhaja, se ka pasë

mungesë gjithmonë t'sasisë t'ujit t'mjaftushëm se distanca ka qenë e largët. Mu gjithmonë m'kujtohet që edhe rrobat kur i pastrojshin e kena pasë rekën, u kanë ni kilometër larg që u dufke nanat tona edhe gjyshet tona me i bajtë rrobat, me i çu me i pastu n'rekë.

Atëhere u kanë metoda klasike, as s'ka pasë detergjent, jonë la me hi. Shumica e pastrimeve jonë bo me hi që osht' metë n'oxhak. Jonë kanë ato porajkat realisht që i kanë rreh teshat se s'ka pasë lavatriqe tash që po i shtrydhin. Po realisht qajo ka qenë metoda që... ka qenë një jetë me t'vërtetë e vështirë. M'kujtohet, po me kthy historinë mrapa për neve osht' pak ma vështirë se jena ardhë në një gjendje shumë ma t'mirë.

Anita Susuri: Po osht' me rëndsi që mos me u harru këto...

Shyqyri Sadiku: Jo me harru, jo. Na si gjeneratë që i kem përjetu nuk i harrojmë kurrë. Po, une shumë here e kom për detyrë edhe fëmijëve me i'u spjegu këtë histori realisht. Une i'u spjegoj do histori kanihere që, une n'vit i kom pasë ni parë opanga, m'i kanë ble. S'kena pasë realisht, se e tillë u kanë jeta. Po sot krejt Kosovën me ma falë nuk ndi kënaqësi ma t'madhe se kur m'i kanë ble ni parë opanga atëherë. Kënaqësia ka qenë e madhe se i ke pasë mrena vitit ni parë këpucë. Këpucë po flas opinga. Opinga prej llastikut të Pirotit, edhe gjatë krejt vitit i ke pasë qato, ndash qkuej, ndash harxhoj nuk ka pasë mundësi t'tjerame t'oftu.

Se edhe distanca me t'furnizu ty, Mitrovica me Barën ka qenë shumë e largët, jonë kanë dikun gati 20 kilometra edhe lëvizja ka qenë n'kamë. Nuk ka pasë rrugë, infrastrukturë nuk ka pasë edhe lëvizja ka qenë n'kamë. Realisht, atëhere ma shumë me kuaj kanë lëvizë po flas, nuk ka pasë rrugë për qerre. Qerre s'ka pasë, shumë vonë, mos t'flas, viteve '70-ta kanë fillu rrugët m'u hapë për knena.

Anita Susuri: Deshta me ju pytë edhe diçka për shpinë se e përmendët edhe nxemjën e ujin kështu për me bo banjo. A e keni pasë ni hamamxhik krejt, a secila dhomë e ka pasë?

Shyqyri Sadiku: Secila dhomë e ka pasë, realisht po. Atëhere e ka pasë secila dhomë në kullë. Në tri dhomat që kanë qenë lartë, realisht përveç dhoma e pritjës, të gjitha kanë pasë banjon, që the ti hamamxhik, secila e ka pasë t'vetën. Plus e kena pasë banjon ose WC, e kena pasë katin e dytë, që s'kena pasë nevojë me dale jashtë absolutikisht.

Korab Krasniqi: E gjumin qysh e keni organizu?

Shyqyri Sadiku: Gjumin e kena organizu n'mënyrë kolektive. Këta që jonë kanë t'moshum kanë flejt ni ven. Na çka jena kanë ni gjeneratë po flas kena ra ni ven krejt. Nashta ka ndodhë shtatë vetë, dhetë vetë kena flejt ni dhomë. N'mungesë, domethanë s'ke pasë hapësirë ma t'madhe, si gjeneratë. Çikat ose femnat që jona kanë vajza kanë flejt ni dhomë bashkë. Edhe qishtu ka qenë organizmi i tillë.

Korab Kraniqi: Domethanë ju keni jetu me gjyshën, gjyshin...

Shyqyri Sadiku: Po, gjyshën, gjyshë... Kom jetu me gjyshin, gjyshën, kom jetu me mixhën e babës, mixha i babës, ka qenë vëllau i babgjyshit, shumë ma i ri. Domethanë, kena jetu n'bashkësi familjare, 33 anëtarë jena kanë që kena jetu n'atë kullë. Po tanishi pak ma lëvizëm, po flas gjeneratat e reja e marum edhe dhomën e pritjës, odën kha, realisht edhe tanishi edhe pak ma lehtë u kanë me lëvizë. Dhoma e pritjës, musafirët u vendosnin knena, që te musafirët realisht ushqimi ma kualitativ, ma i miri ka shku në oda të tilla.

Atëhere ka pasë musafirë shumë, ka pasë musafirë që vishin ka ni javë, dy javë kanë nejt, besom. U kanë ni kënaqësi kur vishin nipat, mesat. Jena kanë t'afrum, jena kanë t'bashkum, jena kanë shumë... po flas, nashta n'histori s'kemi qenë ma t'bashkum të tillë po flas. Skamje kena pasë, hjeke kena pasë po kënaqësia ka qenë n'nivel, dashnia ka qenë mes njerëzve edhe përkrahja ka qenë shumë e afërt. Po flas, të gjithë kena qenë unik. Kena qenë edhe kojshitë e tjerë, po gjithmonë kena qena t'bashkum. Nëse dikush ka pasë nevojë diçka me i nimue, t'gjithë jena çu bashkarisht i kena nimu për diçka

Anita Susuri: Aty n'fshat a ka pasë edhe kulla tjera, a ka qenë e juja...

Shyqyri Sadiku: Po ka qenë edhe ni kullë n'anën tjetër të Barës, po flas n'tri pjesë ka qenë. Ni ka qenë n'këtë pjesën... ka qenë me mbiemrin Xhafa edhe njo ka qenë me mbiemrin Tarati.

Anita Susuri: Domethanë, ata që kanë pasë kulla jonë kanë si familje ma t'ngritun...

Shyqyri Sadiku: Ma t'ngritura, po, realisht po. Se katragjyshi jem ka qenë ma i ngritur, thuhet ka qenë njeri i pasur n'atë kohë realisht. Edhe me t'vërtetë u kanë vështirë n'atë kohë me maru kullë të tillë.

Anita Susuri: Me çka osht' marrë ai, a e din?

Shyqyri Sadiku: Nuk e di, realisht nuk e di se edhe ai ka vdekë në ni periudhë shumë t're, nuk e di. Sigurisht, realisht atëhere jonë merr me tregëti. E vetmja alternativë, me blegtori, me tregëti, me gjana të tilla se s'ka pasë naj hap tjetër.

Korab Krasniqi: Mu po m'intereson për fëmininë e juaj përveç obligimeve që i keni pasë n'shkollë, me u kujdesë për kafshët, me blegtori, me i nimu babës, nanës, kohën e lirë qysh e keni shfrytëzu? Çka keni pasë qef me bo?

Shyqyri Sadiku: Kohën e lirë tash realisht i kena pasë edhe lojnat tona që i kena pasë. Po jena kanë t'kushtëzum atëhere realisht edhe me lojna tona m'u merrë, se nifarë forme na kanë mbikqyrë ata shumë. Jo duhet me i rue delet, jo duhet me i rue shtazët, loptë, jo i kena pasë bollicat që i kena rue. Jena kanë nifarë forme t'kufizum edhe n'aktivitetet tona m'u merrë.

Korab Krasniqi: Çfarë loja keni lujtë?

Shyqyri Sadiku: Kena lujtë klikkash.

Anita Susuri: Me klikera a?

Shyqyri Sadiku: Me klikera, me klikë, u marojke klikë, u kanë ajo e mrehtë, e marojshum edhe u dufke me matë me to. Lujshum n'grupe, u dajshum n'grupe. Kena lu futboll që shumë pak na kanë lanë realisht me lu me futboll, se topin e kena dashtë tanë, futboll me lu. Shumë pak po kena lu edhe lojna tjera. Mshefas, n'mramje kena lu mshefas. Kena lu kilas që po thojnë tash, me ja lanë kilën dikujt. Realisht qato kanë qenë, loja me guracaka. Në mramje zakonisht u bojshim ekipe, u bashkojshum edhe femnat që jena kanë ma t'ri, edhe mashkujt, edhe lujshum bashkë. Kena lu tanishi mos t'flas. Kena lu s'bashku filxhanash, u kanë ni lojë filxhanash që lujshum, domethanë edhe u kanë ni kënaqësi e madhe.

Anita Susuri: Me gjetë n'cilin filxhan osht' mshef ai...

Shyqyri Sadiku: Po, po, po. U mshefë, po. Realisht u kanë, u dufke ti me gjetë, ai që u kanë kokrra e mbyllne n'to, gjithmonë u dufke m hapë, tjerët çka ishin domethanë t'thatë. U dufke, ne gjithë ata filxhana, realisht shtatë-tetë, u mshefke ni kokërr që ti u dufke me gjetë për me fitu lojën. Edhe kur e kena asi, se u bojshim dy ekipe edhe ekipa që fitojke e knojke kta që hupke. Kena lu edhe dogërrxhik, realisht u kanë sistemi...

Anita Susuri: Qysh? Dogërr...

Shyqyri Sadiku: Po, dogërrgjik. Jonë që vizatohen, luhet me kokrra t'pasulit, luhet edhe me kokrra t'misrit. Osht' edhe ni lojë, se tash i kena lue po flas n'terren kena lue edhe me kto strellat po flas, që gjujshim me...

Anita Susuri: Shigjeta.

Shyqyri Sadiku: Shigjeta, po. U kanë ni lojë të tilla që i kena përdorë atëhere që si fëmijë... se jena kanë t'kufizum, po flas, jena kanë shumë t'kufizum se kena pasë mbikqyrje shumë t'mdhaja për shkak që u dufke me u përcaktu kah, kah delet, ka bagëtitë, me i ru. Realisht, atje jena kanë t'përcaktumë ma shumë. I kena pasë detyrat e ndame, detyrat i ken marrë n'mramje, edhe çdonjani e ka pasë detyrën e vet.

Anita Susuri: Deri n'cilin vit ju keni jetu n'qat shpi? N'qat kullë?

Shyqyri Sadiku: Unë kom jetu deri n'vitet e '76-ta, ni bashkësi familjare të tilla. Edhe kulla u kanë dikun po flas, tanishi ka jetu mixha i babës n'atë kullë, po.

Anita Susuri: '76 domethanë u nda familja?

Shyqyri Sadiku: U nda, jena nda si familje. Mixha i babës ka metë n'kullë ktu në Bare, na me mixhallarë jena shpërngulë në Vushtrri.

Anita Susuri: Domethonë qat vit ka ndodhë kjo?

Shyqyri Sadiku: Po, qat vit.

Anita Susuri: E tani në Vushtrri, se Vushtrria osht' si ni qytet i vjetër, qytezë e vjetër, qysh i'u ka dokë Vushtrria juve? A ka pasë ma shumë turqeli qe folnin tuqisht?

Shyqyri Sadiku: Po, qashtu realisht, po. S'kena pasë naj, tash po flas, naj mikpritje t'mirë, realisht po flas se neve na kanë konsideru si fshatarë n'atë kohë. U kanë koxha vështirë m'u kyçë në sistem t'tillë. Nuk m'ka ardhë lehtë, po flas si fëmijë une atëhere kur kom fillu, edhe n'shkollë kur jom shku. Nashta n'forma t'ndryshme na kanë qujtë katunarë e sene, ofendime t'ndryshme kanë qenë. Po u duftë me i tejkalu situatat e tilla. U duftë me menu gjithmonë po flas për familjën.

Edhe Vushtrria po, dihet që osht' ni qytet i lashtë realisht. Edhe n'atë kohë ma shumë nashta po flas pjesa kah qyteti, ma shumë jonë kanë t'përcaktumë si... po flas si, tuqishtën e kanë njoftë. E u kanë pak vështirë për neve, realisht une shumë pak jom kanë i orientumë kah Vushtrria, ma tepër jom kanë i orentimë kah Mitrovica. Gjithmonë kom mendu ka vendlindja, se prapë na edhe që jena ra, jena shpërngulë vitet '76 në Vushtrri, tokën nuk e kena shitë në Bare.

Edhe deri n'vitet '90-ta jena dalë gjithë e kena punu tokën. E kena pasë obligim. Jena dalë i kena thurë pronat tona, livadhet tona, edhe i kena kositë gjithë. Edhe e kena punu tokën deri n'vitet '90-ta. Domethanë, gjithmonë jom kanë i lidhun prapë me fshat.

Anita Susuri: E pse bash në Vushtrri keni shku?

Shyqyri Sadiku: Po nuk e di realisht pse. Nashta, po flas, shpërngulja e tillë ka qenë nashta edhe ni hallë e imja që ka jetu atje prej ni fshtatit, Bozhlanit, u shku n'vitet '60 e diçka, osht' shpërngulë aty edhe sigurisht po menoq që ajo i ka lidhë. Domethanë, motra e babit tim ka jetu aty edhe nashta ajo ka qenë ma tepër m'u afru ngat dikuqjt që e njeh. Shpërngulja ka qenë e tillë. Po na gjithmonë, po flas për vete realisht, shumë pak jom lidhë me Vushtrri sa jom lidhë me Mitrovicë.

Se gjithmonë Mitrovicën e kom shumë n'zemër se edhe jom lindë n'qit pjesë qikho, edhe prapë edhe sot vazhdoj t'shkoj n'fshatin tim, edhe qajo m'ka lanë përshtypje ma t'mirë. Edhe njerëzit domethanë jonë kanë... shkollimi u kanë kah Mitrovica, përpos shkollën fillore ni pjesë qe e kom kry në Vushtrri, jom orientu kah Mitrovica. Edhe gjithçka jom kanë i lidhun me Mitrovicë edhe me “Trepçë”.

Anita Susuri: Domethonë, ti koke ardhë në Vushtrri dikun nimbëdhetë vjeçarë?

Shyqyri Sadiku: Dymdhetë vjeçarë, po.

Anita Susuri: Qysh t'u ka dokë ty Vushtrria, a u kanë hera e parë që e ke pa?

Shyqyri Sadiku: Jo, hera e para nashta ka qenë në vitet '73, që e kom pa për herë t'parë. Edhe për herë t'parë që jom shku te halla po flas ka qenë ai vit. Jo najfarë që m'kanë marrë me m'çu, po e kom pasë ni problem realisht, në fshat Bare. Jom rrëzu, e kom pasë ni lëndim n'kokë t'ranë edhe m'kanë çu te mjeku në Mitrovicë, edhe tanishi për pamundësi me u kthy në fshatin Bare, m'kanë çu te halla. E kom qenë për hera t'parë n'vitet '73 nashta që e kom taku qytetin, nashta për herë t'parë që jom zhdjergjë edhe në Mitrovicë.

Në vitet '73 se s'kena pasë mundësi na me ardhë n'qytet, se u kanë ni zot shpije që i ka lëvizë t'gjitha punët. Domethanë, e ka marrë ia përgjegjësinë me ardhë n'qytet me i marrë t'mirat materiale çka i nevojitën familjës, ai ka qenë përgjegjës. Të tjerët jonë kanë përgjegjës për punët e tjera me i punu. Edhe qajo ka qenë hera e parë qe e kom pa, m'u ka dukë ni ven, tash po flas, realisht diçka krejt, që s'kom mendu qe osht' i tillë.

Tash na s'kena pa edhe shumë tokë rrafsh, tokë pjellore atëhere, se na ma tepër n'fshat jena lidhë. E kom pa, u kanë koha e misrit atëhere, kur e kom pa misrin shumë t'gjatë m'u ka dokë diçka si me kanë tjetër botë realisht po flas.

Anita Susuri: Je çuditë pse nuk e kanë punu misrin?

Shyqyri Sadiku: Po, po de. Jena çuditë realisht, tash po. Qajo hera e parë, tash hera, po flas tanishi ma vonë kur jena shpërngulë ka qenë viti '76.

Pjesa e Dytë

Anita Susuri: Qysh u kanë tani qajo jeta juj, qysh u kanë kur jeni shpërngulë?

Shyqyri Sadiku: Po jeta, jeta ka vazhdu, tash realisht nuk muna me thanë qe... prindi jem, baba, osht' punësu në “Trepçë” ka punu. Mixha osht' punësu në “Kosovatrans” atëhere, ish “Kosovatransi” i

Mitrovicës. Edhe ky mixha i vogël, edhe ky ka qenë n'studime në Shkollën Teknike në Mitrovicë. Ka qenë nja tri-katër gjenerata, pesë gjenerata para meje. Edhe ai fatbardhësisht osht' punësue në minierën e Kishnicës, në vitin '78 ai u punësu. Edhe tanishi e krijumë nifarë jete pak ma t'mirë realisht.

Une fillova studimet ktu n'shkollë teknike. Masi i kryva studimet e shkollës teknike e regjistrova fakulltetin Xehtaro-Metalurgjik në Mitrovicë, që ka qenë në pjesën veriore. Por, për shkak t'kushteve, t'pamundësive po flas realisht, atëhere nuk kom mujtë me i vazhdu studimet, dhe osht' shpallë ni konkurs në minierën e Stantërgut për teknik të xehtarisë. Kom konkuru, kjo ka qenë n'vitin '81. Une i kom mbaru studimet n'qershor, konkursi osht' hapë n'korrik edhe kom apliku, edhe jom pranu. Jom pranu si teknik i xehtarisë.

Edhe kom fillu punën me 19 tetor të vitit 1981. Për herë t'parë qe kom fillu punën këtu, edhe jom kanë n'moshë shumë i ri, n'moshën 18 vjeçare. Edhe prej atëhersh, tash po flas realisht, nashta edhe jom lidhë shumë me "Trepçën", edhe gjithçka jom n'gjendje me dhanë për "Trepçën". Se nashta hapat e parë të rinisë time kom fillu ktu, po flas hapat e parë, që nashta jom kanë n'atë moshën që jom kanë i pavarur realisht.

Anita Susuri: Deshta edhe pak diçka me ju pytë për, domethonë gjatë shkollës t'mesme, ju thatë që n'fshat keni pasë shumë punë edhe s'keni pasë kohë për diçka aktivitete tjetër me thanë, po kur keni ardhë në Vushtrri edhe qito jonë hekë, qito punë që keni pasë...

Shyqyri Sadiku: Jonë hekë disa, po realisht krejt s'jonë hekë, se une po flas, deri n'vitet '90-ta prapë jena kanë t'lidhun me fshat. Gjithmonë jena kanë të lidhun me fshat. I kena pasë tokat, i kena pasë malet, i kena pasë që punojshum, millshum diçka atje. Plus e kena pasë sezonën kosa kur u kanë me kositë. Une jom kanë n'punë realisht ktu, po prej pune prapë edhe që jena ra në Vushtrri, na shumë s'kena mujtë me ndërru nga fshati. Se edhe aty e kena pasë ni zot shpije që edhe ai osht' përkujdesë n'mramje ka dhanë nifarë orari t'punës.

Gjithkush i ka pasë detyrat e përcaktuara n'punë. Dikush ka pasë me ardhë n'fshat, dikush ka pasë me punu aty tokën, po flas, me millë, qepë, e jo do gjana të tjera po flas. Po dikush ka pasë punën që u kanë n'punë t'shtetit. Po kur e kena pasë kohën e lirë, po flas, pushimet, e kena pasë ni orar që jena bo bashkarisht edhe jena dalë shumica kena punu n'fshat.

Anita Susuri: Domethanë, sa jeni kanë i ri gjatë shkollimit edhe studimeve, a keni pasë kohë si t'ritë që kanë dalë ose kanë bo diçka, organizim me shoqni, a orgaznim kulturor diçka?

Shyqyri Sadiku: Shumë pak, realisht shumë pak kena bo. Realizime të tilla shumë pak kena bo, sa i përket na mashkujve apat diqysh e kena gjetë naj hapësirë, naj here ikshum. Po flas, nashta edhe n'mënyrë t'mshta i kena bo organizimet e tilla, po sa i përket gjinia femërore ka qenë shumë e kufizume. Nuk ju ka dhanë asni hapësirë realisht gjinisë femërore, shumë pak nashta ka pasë njerëz që

ke mujtë m'i numru n'gishta të gjinisë femërore që kanë mujte me i përjetu kto aktivitete. Ato janë merr me punë t'shpisë realisht. Kanë punu, ju kanë ndihmu nanave edhe krejt punët i kanë kry rreth shpijave. Shumë pak ka pasë që i kanë lanë, nashta po flas shumica kanë kry tetë-vjeçarën e ma tutje nuk i kanë lanë edhe me u shkollu. Pë shkak e dini edhe ju, problemet që kanë qenë t'tilla atëhere.

Anita Susuri: A ka qenë edhe te ju n'familje qashtu?

Shyqyri Sadiku: Po, po ka qenë realisht...

Anita Susuri: Motër a keni pasë ju?

Shyqyri Sadiku: Po, po. Une po flas, jemi ni familja e gjanë, jemi katër vllazni e pesë motra, po. Ato motrat që kanë qenë para meje tash kanë pasë shumë vështirësi realisht t'shkollimit. Tash këto gjeneratat ma t'reja, qe janë kanë motrat mas neve nuk e kanë pasë këtë problem. Se kena ndiku ka pak edhe na si gjeneratë e re realisht që me i dhanë hapësirë edhe atyne me u shkollu, se edhe ato kanë të drejtë, sikur na që kem të drejtë, edhe ato kanë të drejtë realisht me përjetu, me u shkollu, pse jo?

Kjo ndoshta ka qenë edhe ndikim i politikës komuniste ish-Jugosllave që i kanë pengu gjanat e tilla. Mos me i lanë m'u shkollu, mos me i lanë me shku n'shkolla. Na kena pasë vështirësi, po flas prindi jem ka pasë shumë vështirësi, shumë u kanë ni nxanës i zgjum sa ka qenë, se ai veç katër vjet shkollë në Bare. Po ka qenë ni nxanës shumë i zgjuar që ka mujtë shumë me dhanë ni kontribut në t'ardhmën, nuk e ka lanë prindi i vet me shku n'shkollë për shkak t'përcaktimeve që i kanë pasë atëhere fetare. Jo hoxhallarë që janë kanë, po flas, të tillë që nashta edhe kanë qenë t'pagum prej ish-sistemeve të tilla që, "Mos i çoni fëminë n'shkollë se bahën shkije". Qaj ka qenë koncepti i tyne n'krye.

I kanë detyry m'i majtë atëhere plisat e bardhë, qeleshet, plisat. I kanë detyru. Tash mixha jem që ka qenë, ka vazhdu studimet, nashta i pari ka qenë ai mixha i tretë që ka fillu shkollimin në Mitrovicë, shkollën e mesme, u kanë i detyrumë me majtë plisin. Prej Barës me qitë plisin, me ardhë n'shkollë në Mitrovicë, realisht që ka qenë ni vij e gjatë, po flas. Mas viteve '70 ka qenë i detyrumë, që ka qenë nifarë forme me t'vërtetë shumë vështirë me bindë babën e vet për me shku n'shkollë, me i vazhdu studimet n'shkollën e mesme, atëhere ka qenë Normalja.

Edhe realisht prej mixhe, mixhës t'tretë ka fillu shkollimi janë ka pak, që kanë lëshu pe. E kanë pa ma vonë edhe prindërit që kanë pasë gabime t'tilla, po me t'vërtetë sistemi ka qenë i tillë që atëhere më tepër edukimi ka qenë nëpërmes hoxhallarëve. Me mejtepe realisht, që i kanë penugue, "Jo, s'bon me shku n'shkollë, jo s'bon femna me dalë, jo s'bon..." Edhe domethanë kanë kriju bindje të tilla që për mu kanë qenë bindje t'gabume. T'gabume që na kanë kushtu edhe si komb. Se ma mirë u kanë me kanë i hapur, gjithmonë me i'u jep mundësia më u shkollu.

Korab Krasniqi: Dashta me u kthy edhe nihere kur jeni dalë në Vushtrri. Jeni da me...

Shyqyri Sadiku: Mixhen e babës.

Korab Krasniqi: Me mixhën e babës edhe jeni dalë në Vushtrri. Qysh e keni ble shpinë në Vushtrri? Edhe qysh ka qenë qikjo damja, çfarë... logjika, cila u konë logjika kur jeni dalë, qysh jeni nda?

Shyqyri Sadiku: Po tash procesi atëhere u kanë i familjës. Tash ni familje e gjërë kur u bo realisht, po flas prej 33 anëtarëve, tash u kanë vështirë edhe, edhe... nuk po flas n'atë aspektin, se për punë u kanë shumë mirë. Po kur jonë ulë me hangër buk e sene ka qenë pak punë e vështirë, po flas për nanat tona, për motrat tona që u duftë me përgaditë 20 bukë me i gatu. U duftë me i pjekë tri krelana, katër krelana. Une po flas, tri sofa jonë shtru te na realisht. U kthy e burrave, u kthy e fëmijëve, u kthy e femnave.

Nashta ka ndodhë kur ka pasë musafirë edhe katër sofa jonë kthy. Domethanë, tash, nuk osht' pak katër mëngjesa, katër dreka, katër darka. Realisht ka qenë ni mund shumë i madh, edhe ka qenë ni mungesë. Edhe nifarë forme u krijunë kushtet realisht, dalë-ngadalë, tash gjeneratat vijnë tu u rritë realisht. Na vishim tu u rritë, edhe tash po flas, vendosja në Bare nëj gjo të tilla, tash une nuk di, atëhere na nuk jena vetë, s'jena kanë vendimmarrës. Po thuhet, sipas fjalëve që i kom dëgju, gjyshja, gjyshi ja kanë lanë amanet që me u shperngulë prej Bare.

Arsyet nuk i di pse, po ja u ka lanë amanet... se nashta ka hjekë ai vet shumë, ka kalu faza të vështira, i ka pa gabimet që i ka bo, të tilla edhe për qat arsye realisht nashta ka ndodhë edhe shperngulja. Qikjo ka qenë prej babgjyshit, i ka thanë që duhet me u shperngulë, edhe thojnë ja ka lanë qasaj çikës t'vet, po flas që kena anu ka Vushtrrija ka qenë qajo çika që ka vendosë. I ka thanë që me i bartë, me i afriu ngat vete. Edhe tash na shumë afër jem me atë hallën aty që jetojmë në Vushtrri.

Korab Krasniqi: E shpinë qysh e blejtët?

Shyqyri Sadiku: Shpinë, na e kena ble tokën nihere. Edhe shpija osht' maru atëhere, ti e din, po flas, nashta krejt metodë klasike, jonë pre tullat n'mënyrën ma klasike, osht' bajtë dheu me qërpiq osht' bajtë. Osht' ndërta realisht ni shpi, që ka qenë ni shpi, po flas, n'krahësim me kho ku kena jetu ka qenë shumë ma komode, ma e bukur.

Korab Krasniqi: Kush e kush ka ndejt n'atë shpi?

Shyqyri Sadiku: N'atë shpi kena jetu bashkarisht si familje, baba jem me tre vllazni. Apet jena kanë ni familje e gjanë. Edhe tanë jonë kanë... kta dy mixhallarët e vogël kanë qenë pa martu, kur ka qenë shperngulja në '76 në Vushtrri, baba jem edhe mixha i dytë kanë qenë t'martumë. Na jena kanë nantë fëmijë. Edhe ai mixha i ka pasë shtatë fëmijë. Domethanë apet kena qenë ni familje e gjanë.

Tani ma vonë u martu dhe mixha, tanishi u martu edhe mixha i vogël edhe apet e arritum numrin kho n'fasht që jena kanë, apet u bonëm 33 anëtarë. Edhe në Vushtrri kena jetu n'bashkësi familjare 33 anëtarë. Po atëhere e marum edhe ni shtëpi tjetër, domethanë që lëvizshum... na mashkujt ma tepër rrishum n'këtë shpinë e re knena, edhe musafirët kur vishin, se edhe atje kena pasë musafirë shumë. N'këtë shpinë që u kanë ma e vjetër rrishin gjinia femërore ma shumë edhe fëmija.

Ktu jena nda, une kom përjetu shumë ndarje. Kom përjetu në Bare, kom përjetu në Vushtrri. Dy ndarje. Edhe ktu jena kanë n'bashkësi familjare 33 anëtarë kur jena nda prej mixhallarëve.

Anita Susuri: Edhe mixhallarët edhe vllaznit e tu.

Shyqyri Sadiku: Po tashti kom dalë me vllazni n'shpi, me prindërit edhe me vllazni. Tash edhe me vllazni jena kanë ni familje e gjanë, po flas pesë motra e katër vllazni. Osht' martu vëllau i madh sa jena kanë bashkë më mixhallarë (buzëqeshë) domethanë n'bashksi familjare osht' martu edhe vllau jem i madh. Tash në vitet e '90-ta ju e dini situata qysh erdh, na largunë prej pune edhe une kesh i fejumë. Kur u kanë greva këtu, e minatorëve, që kom qenë pjesë e grevës, kom qenë i fejumë. Situata e tillë, diku vitin '91 jom martu une, masi na kanë largu prej pune.

E na tashti edhe si familje ja nisëm m'u rritë, po flas mrena për mrena. Vllau krijoi familje, edhe une u martova me kriju familje, edhe vllau i tretë u martu. Edhe tani fillunë shpërnguljet, ju e dini, shpërnguljet prej Kosove.

Anita Susuri: Para se me vazhdu anej, po kthehemi, tregutë që në '81 keni hi n'punë. Po në '81 jonë konë edhe demonstratat, u konë ni situatë shumë problematike, e ndërlikume. A ju kujtohet juve krejt qato ngjarjet edhe a keni marrë pjesë ju? Na tregoni.

Shyqyri Sadiku: Po, realisht, po. Drejtën me t'thanë kom qenë maturant i vitit t'katërt në Shkollën Teknike. Edhe kur kanë fillue, demonstratat kanë fillue me 11 mars të vitit '81, kanë fillu studenët në Prishtinë realisht, po ajo ka lëvizë gjithmonë. Po informacionet i kena pasë t'mangëta atëhere, se sistemi u kanë i tillë realisht, që s'kanë lanë hapësirë me pasë informacione t'tilla. Edhe na si gjeneratë e re realisht, demonstratat ma masive kanë fillu prej 1 prillit tanishi.

Me 11 mars kanë fillu realisht, kanë vazhdu, nifarë forme i kanë blloku, kanë fillu arrestimet e tilla. Na kena pasë informacione ka pak, po flas që kena punu. Edhe po flas prapë, 1, 2 edhe 3 prill kanë qenë demonstratat masive në gjithë Kosovën. Na kena qenë në Teknik si nxanës realisht edhe... po ju kena bashkangjitë atyre demonstratave edhe kena demonstrue. Jena kanë t'përndjekur realisht që jena kanë n'forma t'ndryshe t'bllokumë që mos me dalë, mos me i përkrahë.

Se u munu atëhere ish-pushteti Jugosllav me i zvogëlue, mos me ju lonë hapësirë njerëzve me kërkua atë që ju takon. Se kërkesa gjithmonë ka qenë që Kosova të jetë republikë edhe të i ketë të drejtat e barabarta me republikat tjera. Se na kena qenë gjithmonë të shtypur nga regjimi ish-jugosllav, e më tepër nga regjimi serb. S'na kanë lanë hapësirë realisht. Jena kanë t'detyrumë, po flas kur jena kanë n'shkolla të tilla me mësu e kena pasë gjuhën serbe obligative. Je kanë i detyrumë me mësu realisht.

Jena kanë të, të... po flas, jo të barabartë me të tjerët. Edhe gjithmonë kjo ka ngjallë një lloj shprese. Gjithmonë rinia ka qenë e ardhmja e ni populli. Kena qenë n'demonstrata të gjithë të bashkumë, po flas na kena qenë ma t'pjekun si maturantë që jena dalë n'rrugë, kena protestue...

Anita Susuri: Qysh ke marrë vendim ti me shku në demonstratë?

Shyqyri Sadiku: Po, kom marrë vendimet se vendimet i kena marrë t'përbashkta atëhere, si klasë. Nuk jonë kanë vendimet e individëve. Po si klasë i kena marrë vendimet e përbashkëta. Po tash po flas si shkollë, si Shkollë Teknike kena marrë vendimin që na duhet me dalë me i përkrahë studentat se edhe na nesër kena mujtë me qenë studenta të tillë, edhe presekutimet e tilla që ja u kanë bo studentave, arrestimet e tilla... ata kanë qenë vllazën, motra tona, realisht kena ndi edhe na dhimbje. Edhe ajo na ka detyru me dalë n'rrugë edhe na.

Anita Susuri: Në Mitrovicë ju keni dalë?

Shyqyri Sadiku: Në Mitrovicë. Në Mitrovicë kena dalë edhe kena protestu. Edhe kanë qenë, t'drejtën me t'thanë kanë qenë represionet shumë t'mdhaja. Na kanë përndjekë policia në forma t'ndryshme, jonë munue gjithçka me heshtë, më mbyllë, gjithçka mos me qenë në opinion. Po falë, po flas edhe atëhere gazetarëve që ka pasë, mediave që kanë gjetë forma t'ndryshme që na kanë informu. Edhe atëhere u kanë vështirë edhe për media edhe për gazetarë me dalë n'opinion me gjana t'tilla me folë, po na mburrëm me ato gjenerata që i kena pasë, edhe që kanë pasë ni guxim t'tillë, edhe e kanë përhapë n'krejt botën domethanë. Informacioni ka qenë... e inofrmume ka qenë krejt bota që në Kosovë ka demonstrata edhe lëvizje t'tilla.

Ka pasë edhe viktima shumë, informacionet sigurisht i keni, ka pasë edhe burgosur shumë, edhe t'keqtrajtumë, edhe t'rrahun. Edhe n'forma t'ndryshme dhomethanë kena qenë n'forma... po na mburrëm për ato që e kena bo. Se kena pasë obligim, obligim e kem për kombin edhe për shtetin tonë, s'pakti diçka me dhanë se njerëzit kanë dhanë shumë. Po flas, nuk osht' kjo që u nisë me neve, kanë qenë demonstrata edhe ma herët në vitet '68, që edhe ato e kanë bo ni lëvizje, ka qenë ni promotor.

Na falë demonstratave '68 e kena fitu ni, ni autonomi, po flas ni gjysëm autonomi t'pavarun qe nashta ka qenë hapi i parë që n'vitet e '70-ta ka fillu Universiteti i Prishtinës, që aty na u kanë çelë dyrët e dijes së shqiptarëve, s'paku me ardhë me na u hapë rruga edhe shqiptarët me arritë ni shkollim që e meritojnë. Pa lëvizje të tilla na nuk kishim mujtë me arritë kta, çka kena arritë.

Anita Susuri: Deshta me ju pytë ni, ni anë ma subjektive për shembull, qato dit' që keni dalë, çka keni pa ju aty? A ka pasë dhunë, a ka pasë polici, a ka pasë ikje?

Shyqyri Sadiku: Po, gjithsesi. Gjithmonë. Çdo grumbullim që ka qenë jemi kanë të përndjekur nga policia. Dhuna ka pasë n'forma t'ndryshme. Ka pasë shumë t'arrestum, kon kanë mujtë me nxanë e kanë arrestue realisht. Ka pasë dhunë, osht' përdorë në forma t'ndryshme. Nashta dhuna ma tepër osht' përdorë nëpër stacione t'policisë t'ndryshme, që malltretimet kanë qenë nashta ma çnjerëzore ndaj njerëzve, po flas ndaj gjeneratave të reja atëhere që kanë qenë. Se gjenerata e re ka qenë e tillë... po.

Edhe ajo ndoshta ka qenë indikacion që gjithë atë dhunë, gjithë atë represion që e kena pasë na ka shty me qenë edhe ma t'bashkumë se me t'vërtetë e kena ditë qe kërkesa osht' e arsyshme. Na kena lypë diçka që na takon, jo që s'na takon. Edhe ajo ka qenë nashta, po flas, bashkimi i nxansave edhe studentave, po gjithmonë po flas edhe i qytetarëve. Se mos me qenë ni lëvizje, po flas e t'gjithëve rezultati kish mungu.

Anita Susuri: Masi edhe familja ju j me vite ka qenë kështu, si me thanë pariotike se kanë qenë këto lëvizjet kombëtare. A e ke ndje edhe ti si një lloj detyre që me konë prezent kur u kërku diçka me bo për Kosovë, për...

Shyqyri Sadiku: Po kom ndi une tash, po flas prej viteve kur kom qenë si fëmijë, shpjegimet që na ka dhanë gjyshja, ato na u kanë ngulitë n'menje. Domethanë, gjithmonë e kena pasë, po gjithmonë kena punu me kujdesje realisht. Po e kena pasë obligim, po flas, se historia osht' e gjatë. Tash ni hstori kur e merr ti si fëmijë, t'tregon hjekat që i ka pasë prej ni regjimi t'tillë komunist familja, ti gjithmonë je kundërshtar i tij. Edhe hapi i parë që t'jepet realisht me reflektu, ti duhet me reflektu, duhet me i goditë.

Realisht se ai sistemi komunist, po flas për ni familje në përgjithësi shqiptare ka qenë jo i mirë. Ka qenë ni sistem i tillë që, që i ka ngulfatë çka kanë punu njerëzit për çështje kombëtare. Ata realisht i kanë ekzekutu. Ka shumë familje që kanë pësu, i kanë ekzekutu krejt. Po gjithmonë kena qenë bashkëpunues, une po flas për veti, uën gjithmonë si familje e kena pasë n'mendje edhe n'frymë që kjo situatë duhet me ndryshu. Një gjo e tillë duhet me ndryshu. T'parët tonë e kanë fillu këtë iniciativë edhe na e kemi obligim me vazhdu. Po dikush ma shumë, e dikush ma pak.

Anita Susuri: Edhe kur erdhët këtu me punu në '81, qysh u vrejtë që po shkon puna, a u vrejtë ajo pakënaqësia...

Shyqyri Sadiku: Po, realisht, po flas n'vitin '81 une jom pranë si teknik. Me t'vërtetë menaxhimi gati u kanë krejt prej serbëve. Nashta edhe gjuhë zyrtare u kanë edhe ma shumë, po flas edhe vitet '81 kur

jom ardhë, kur jom shku n'horizonte si mbikqyrës, shumica e librave kanë qenë t'shkrume serbisht. Nashta orari u dhanë serbisht, se shumica edhe e njerëzve që kanë qenë në vende të tilla që kanë udhëheqë janë kanë njerëz t'pashkollum. Xehtarë me kualifikim t'lartë, sene, i kanë emru, domethanë kanë qenë t'ndikum prej sistemit komunist.

Fatbardhësisht, po flas fatëbardhësisht me lëvizjet e '68-tës, me hapjen e perspektivës, me studimet e gjeneratave t'reja, me kryrjen e fakulteteve janë instaluar këtu edhe rinia shqiptare. Ajo ka qenë nashta merita ma e madhe e atyne që janë ardhë. Kanë fillu rinia hapat e parë me i bo në Stantërg, po flas n'vitet ma t'hershme, po kanë qenë shumë pak. Kanë qenë ni ose dy individë.

Prej viteve '80, po flas '79, '80 kanë fillu gjeneratat e reja me dalë prej fakultetit Xehtarë-Metalurgjik edhe ka pasë inzhinierë shqiptarë që janë ardhë janë kyçë, po paralelisht jena kyçë edhe na si teknikë të xehtarisë. Edhe na tanishi kena marrë obligime si teknikë të xehtarisë me i udhëheqë edhe ndrrimet atje. Na i kena dhanë orar, na i kena organizue edhe faktikisht na jena kanë t'përcaktum që gjuhë zyrtare t'jetë gjuha shqipe.

Na kena pasë shumë herë probleme kur e shkruajmë librin atje, evidencën e shkruajmë n'gjuhën shqipe. Vike ai mbikqyrësi serbisht, thojke une s'pe kuptoj. Po, realisht ti je t'u jetu në Kosovë, ti duhet me kuptue. Ti nëse jeton në Kosovë, ti duhet me mësu edhe gjuhën shqipe. Na jena kanë t'obligum me mësu gjuhën serbe, po edhe ti duhet me mësu gjuhën shqipe se ti je tu jetu n'mes t'shqiptarëve. Edhe realisht problemet e para kanë hasë aty une po flas, kur u ardhë. Edhe kjo m'ka pengu mu si gjeneratë, kur kom pa gjana t'tilla, domethanë edhe janë kanë shumë t'ashpër me punëtorë, se punët edhe mundin edhe prodhimin e kanë dhanë shqiptarët. Krejt e kanë dhanë shqiptarët. Nashta punët ma t'rana fizike në minierë janë kanë shqiptarët t'përcaktum.

Anita Susuri: Ishit t'u më tregu për ato çka keni bo aty?

Shyqyri Sadiku: Po, pas punësimit po flas n'vitin '81, realisht ka pasë padrejtësi t'mëdha. Gjithmonë po flas n'atë kontekstin që shqiptarët kanë qenë nifarë forme që kanë kry punë t'rana fizike, prodhimet i kanë dhanë ata. Pjesën tjetër të menaxhimit e kanë bo serbët, po flas nashta 70-80 përqind të menaxhimit e kanë bo serbët. Po falë, po flas edhe ni here, demonstratave që kanë qenë në vitet e '80-ta, shqiptarët s'paku kanë fitu diçka, kanë fitu t'drejtën e shkollimit.

Me fitimin e të drejtës t'shkollimit është hapë rruga që shqiptarët t'vijnë t'punësohen në "Trepçë". Atëhere, po flas kanë qenë gjeneratat... nashta t'parat që kanë qenë t'viteve '78, '79, '80 që kanë fillu inzhinierat e parë mu kyçë n'miniera nga "Trepça". E asaj gjenerate, pak ma i ri, une i përkas që jom ardhë prej Shkollës Teknikë. Edhe i kena pa padrejtësitë realisht edhe na si teknik, po flas gjithmonë n'përkrahje të inzhinierëve shqiptarë kemi fillu t'punojmë në interes t'punëtorëve.

Edhe kena arritë, kena arritë ni bashkëpunim t'tillë gradualisht, që me t'vërtetë ka qenë nashta ni periudhë shumë e vështirë se je kanë i mbikyqrun nga sistemi jugosllav. Se kjo ka ndodhë n'periudhën e viteve mas '81-ta, shqiptarët janë kqyrë me ni opinion tjetër në ish-Jugosllavi. Jonë qujtë irredendista, jonë qujtë nacionalista, domethanë që kta jonë për shpërbërje të ish-Jugosllavisë. Gjithmonë kena pasë një vëzhgim tjetër si shqiptarë.

Në vitet '81 po flas gjithmonë, kanë qenë noshta hapat e parë që i kom bo si teknik këtu edhe kom fillu hapat e parë m'i marrë, m'i ditë problemet me t'cilat ballafaqohet mrena për mrena "Trepça". Unë i falenderoj të gjitha gjeneratat që kanë qenë ma t'vjetra që atë përvojë e kanë bartë te na. Edhe sot jemi shumë mirënjohës i tyre, që ato gjenerata kanë bartë edhe kemi bashkëpunu shumë afër. Se këtu kena qenë shumica e të punsuarëve kanë qenë të këtij regjioni po flas, regjionit të Shalës. Se miniera i përket këtij regjioni po ka pasë edhe të komunave të tjera. Ka pasë edhe të Gjakovës, ka pasë edhe të Gjilanit, ka pasë edhe të Podujevës shumë, po edhe të Skenderajit.

Dhe kjo ka qenë periudha që nashta hapat e parë që kena bashkëpunu, i kena afri punëtorët, realisht edhe ju kena dalë n'ndihmë. Ato padrejtësi që ju kanë bo n'atë sistem po flas, jemi munu me i kthy ato drejtësi te punëtorët, me bashkëpunu edhe mundin e tyre, edhe njersën e tyre me ja u pagu. Kto kanë qenë hapat e parë po flas realisht. Kom punu deri në vitin '83, në vitin '83 kom shku ushtar, Shërbimin Ushtarak ish-Jugosllav, që po flas publikisht hale andërr e shoh. Vujtjet edhe... po flas persekutimet që i kena pasë kanë qenë me t'vërtetë shumë t'rana për neve shqiptarët.

Anita Susuri: Çka keni përjetu? Se u kanë mas '81-tës shumë...

Shyqyri Sadiku: Po, shumë vështirë u kanë. Në janar '83, domethanë gjithçka kena përjetu veç najsen mirë s'kena përjetu n'sistem jugosllav, po flas n'shërbim ushtarak. Kena pasë çdo natë n'mramje, natën, na kanë thirrë sigurimet e ndryshme t'shtetit na kanë marrë n'pytje. Ka ndodhë në 12:00 të natës m'kanë zgju prej gjumit për me m'marrë n'pytje, "Je tu punu për Shqipni, ju jeni irredentista, ju po doni me shkatërru Jugosllavinë, ju punoni n'forma t'ndryshme... ju veç trupin e keni ktu, mendjen e keni në Shqipëri..."

Edhe ka qenë nashta po flas n'periudhat ma t'shtira. N'kohrat ma t'vështira ka qenë që kemi përjetu diçka t'tillë. Jena kanë t'mbikyqrun çdo hap, nuk na kanë lanë me bisedu grumbull t'shqiptarëve, nuk na kanë leju mrena për mrena n'ushtri. Ni rast e di që jena bashku si t'ri kur jena shku n'ushtri, jena kanë diku 15 veta t'bashkum realisht në ni poligon ushtarak atje që jena ulë me bisedu, kur e kena pasë kohën e lirë, si shqiptarë edhe n'momente të tilla jonë ardhë na kanë arrestu t'gjithëve.

Ka qenë roja e kazermës ushtarake, shërbimin në Kumanovë e kom kry, edhe kanë ardhë na kanë arrestu t'gjithëve. Edhe aty kanë fillu nashta hapat e parë po flas t'përcjelljës të sigurimit shtetror Jugosllav. "Jo, po i fotografoni barnat ushtarake. Jo po boni fotografi të tilla, jo po organizoni grupe

irredentiste për sulm t'kazermave ushtarake". Gjana t'tilla që na njollosëshin, "Ju po punoni po i jepni informacione Shqipërisë për me na sulmu..." Gjana të tilla ka pasë po gjithmonë...

Anita Susuri: Kta t'burgosun the i kanë çu...

Shyqyri Sadiku: Kena qenë, po, kena qenë paraburgim, po. Se ka qenë paraburgimi aty mrena n'ushtri edhe gjana të tilla. Na marrshin natën, n'forma të ndyshme sigurimi, herë në 12:00, here në 1:00, herë në 2:00 t'natës realisht, sipas dëshirave tyne na marrshin n'pytje. Tash t'pytshin historinë krejt ta marrshin, prej si fëmijë kur je kanë, ku ke punu realisht, orientimet e tyne kanë qenë gjithmonë a kanë pasë naj informacion çfarë familje për çdonjanin. Edhe gjithmonë, po t'thom realisht orientimi i tyne u kanë, drejt meje, po flas, ka qenë, "Ti veç qit trup e ki ktu, se menjën e ki në Shqipni".

Ralisht qato kanë qenë, po flas, fyrjet e tyne ndaj neve shqiptarëve. "Ju jeni t'u punu për bashkimin e Shqipërisë t'madhe, ju jeni irredentista, ju po doni me përmbysë Jugosllavinë, ju po doni me mbërmbysë Jugosllavinë, sistemin jugosllav..." E gjana t'tilla po gjithmonë jena kanë në suaza të mbikëqyrjes të ni regjimi të rreptë.

Anita Susuri: Ti a mujshe najsen me ju kthy, çka...

Shyqyri Sadiku: Po realisht jom përgjigjë gjithmonë që nuk osht' e vërtetë ajo çka po e thoni ju. "Nuk jonë shiptarët gjana të tilla, nuk jonë shqiptarët njerëz të tillë. Jonë njerëz të edukum, njerëz që punojnë. Edhe na s'po lypim diçka që s'na takon. Na po lypim diçka që na takon". Gjithmonë kena lypë ni barazim me popujt e tjerë në Jugosllavi. Qito domethanë kanë qenë përgjigjjet tona. Po realisht jonë kanë shumë t'rreptë ata ndaj shqiptarëve gjithmonë. Na kanë mbikqyrë n'forma t'ndryshme. Edhe po flas, nashta gëzimi ma i madh n'jetë u kanë kur kom dalë prej ushtrisë, s'kom besu që kom dalë prej ushtrisë, qe kom ardhë n'shpi.

Anita Susuri: N'cilin ven jeni kanë?

Shyqyri Sadiku: Në Kumanovë. Në Kumanovë edhe në Shkup. Po une e di që gjeneratat para meje, ka njerëz në Shkup që jonë dënu deri me tetë vjet burg për shkak veç që kanë pasë një vizion, një përcakim që kanë qenë shqiptarë, jo për diçka tjetër. Kanë qenë procese të montuara të tilla. Ja u kanë montue proceset e tilla edhe fajtorë gjithmonë i kanë lanë shqiptarët. Edhe gjithmonë na ma s'shumti ju kena tutë, po flas realisht, proceseve t'tilla të montuara. I kanë montu ata vet, po gjithmone fajtorë i kanë lanë shqiptarët. "Shqiptarët po i bojnë, shqiptarët po i organizojnë..."

Që... mos t'thom se gjithmonë çdo shqiptarë duhet me mendu ma s'pari për vetvetën dhe për familje dhe për popull t'vet. Po ka qenë me t'vërtetë, jo veç te na, po te t'gjitha shërbimet, t'gjitha kazemat në ish Jugosllavi, shqiptarët prej vitit '81 e knena kanë vujtë shumë. Ti e din edhe rastet të tilla ka pasë edhe shumë t'vramë. Ka pasë edhe... ka qenë ky procesi i montumë i këtij Kelmendit që e vrajt...

domethanë krejt këto jonë kanë montazha të ish-sistemit që veç shqiptarët me i paraqitë n'arenën ndërkombëtare që nuk jonë njerëz t'mirë, jonë njerëz që nuk punojnë për shtet. Jonë kundër shteteve, kundër pakicave, kunder Jugosllavise realisht. Jonë munu me na paraqitë n'format ma t'kqija.

Anita Susuri: Propagandë e keqe.

Shyqyri Sadiku: Propaganda ka qenë e tillë. Pas kryerjes t'shërbimit ushtarak ju kom kthy prapë punës ktu. Gjithmonë po flas kena punu, na kanë ardhë tanishi me u punësu edhe gjenerata t'reja hala, shqiptarë po flas. Edhe inzhinierë ma shumë edhe teknikë ma shumë, edhe situatën e murrëm gati vet krejt.

Anita Susuri: Deshta pak edhe diçka me ju pytë për... se osht' me rëndësi edhe familja n'qat kohë ju kur jeni kanë n'ushtri. A jonë shqetësu, a jonë frikësu, qysh ka qenë komunikimi juj me ta?

Shyqyri Sadiku: Komunikimi jem shumë ka qenë i mangët se krejt shërbimin ushtarak sa kom qenë, ni herë kom qenë n'shpi, s'më kanë lëshu. Edhe ata kom qenë për ni vikend. Pushimin vjetor s'e kom marrë hiç realisht, se dojsa sa ma shpejtë me dalë prej atuhit, qajo ka qenë ideja jeme. Po, kom qenë veç ni here. Edhe drejtën me t'thanë kto gjana shumë n'shpi s'kom mujtë me i spjegu se realisht ajo ka qenë brengë shumë e madhe e familjës.

Tash me i tregu vujtjet atje që i ki realisht... letrat jonë përcjellë, se atëhere kur shkrujshim, krejt komunikimi u kanë me letra, s'ka pasë lidhje telefonike atëhere. Komunikimi me shpi ka qenë me letër. I shkrujshin letër, m'çojshin familja, m'vetshin, "Qysh je?" Gjithmonë përgjigjja jem ka qenë, "Mirë, mirë, mirë po kaloj". Po realisht naj vizitë najhere kur kanë qenë, ni here ka qenë mixha në vizitë, kur ka qenë ja kom spjegu pak a shumë mixhës. Po i kom thonë që mos ju kallxo n'shpi, prindit edhe nanës.

Po mixha e ka ditë pak çfarë faze... po e kanë ditë edhe kta t'tjerët çfarë fazash po kalojmë, po s'kena mujtë na me shprehë realisht publikisht me thanë. Se osht' përcillë çdo shkresë, çdo letër e jona qe u çu e u ardhë për knena osht' përcillë. E kena pasë shumë kujdes çka po shkruhet edhe n'letër. Edhe kto kanë qenë nashta vujtjet... po flas për gjenerata të tilla deri vitet '88, '89, '90, që ka fillu edhe lufta, kanë qenë nashta gjeneratat ma s'shumti që kanë vujtë, se s'jena konsideru si shqiptarët po si irredentista.

Edhe qito kanë qenë, po flas, tanishi ju kom kthy prapë punës vitet '84, kom fillu ktu procesin e punës. Gjithmonë me mendje t'shëndoshë se e disha çka kom vujtë atje edhe çka kena kalu, çfarë fazash kena kalu. Po gjithmonë kena punu bashkarisht për ni çështje kombëtare, për ni organizim ma t'mirë. Kanë fillu, prej vitit '81 kanë fillu proceset e ish-sistemit jugosllav kundër shqiptarëve. Na kanë çu n'forma ma t'ndryshme, na kanë bo procese t'tilla t'montume tulifare, gjithçka kanë bo veç fajtorë me i shpallë shqiptarët.

Edhe kena fillu, po flas, organizimi ka fillu prej vitit '81-ta e tutje. Kena punu edhe n'grupe t'veçanta, qysh me ardhë, qysh me fillu. Se fillunë autonominë, gjysëm autonominë që kishim fillunë me na copëtu, regjimi i sistemit jugosllav në krye me Slllobodan Millosheviqin. Edhe fillunë realisht, fillunë edhe arrestimet ka pak, largimet e njerëzve që ishin ma eminent, ma kombëtar, për çështje kombëtare që punojshin. Fillunë me i eliminu domethanë prej skene gradualisht...

Anita Susuri: Diferencimi.

Shyqyri Sadiku: Diferencimi, po, qajo ka qenë. Realisht ja nisën edhe në universitet, fillunë diferencimet e tilla ka pak. Edhe kqyrja, edhe qata autonomi që e kishim kqyr... ju e dini edhe vitet '88 po m'doket, kur e majti Kuvendi i Republikës të Kosovës me na marrë autonominë që e kishim viteve '74 edhe me qënë na pjesë ose provincë e Serbisë. Edhe nashta hapat e parë të tillë po flas si reagim kombëtar po flas si çështje kombëtar. Shqiptarët tanë jena kanë të pakënaqun me atë sistem të tillë. Edhe nashta ai u kanë hapi i parë që kena fillu organizimin. Po flas organizimi ka fillu në nivel kombëtar, nuk muna me thanë qe ka fillu në Stantërg gjithçka, po ka fillu gjithkunj ka pak. Kena punu edhe n'grupe të ndryshme, po flas, po une ma tepër kom qenë i përqendur që kom punu në grupe mrena për mrena ktu në Stantërg.

Pjesa e Tretë

Anita Susuri: Ndërkohë deshta diçka... paraprakisht... m'tregutë ma herët që keni pasë njerëz që kanë mbikqyrë, që kanë punu për...

Shyqyri Sadiku: Po, edhe atë detaj e harrova. Gjithmonë ktu prej vitet '81-ta po flas, po edhe ma herët kanë qenë të instalum Shërbimi Shtetëror, serbët që i kanë mbikqyrë krejt lëvizjet mrenda për mrenda i kanë kqyrë. Bonu t'bindun edhe veshjën na kanë përcjellë çfarë veshje po veshëm. Nëse u veshë dikush kuq e zi, realisht menihere e kanë thirrë, e kanë marrë n'pyetje pse, "Pse po i nxitë ti? Pse po veshësh veshje kombëtar, domethanë po i provokon..." Ktu pakicë ka pasë serbë t'punësum, "Jeni tu i provoku..." Gjana të tilla. Domethanë, edhe n'veshje kena pasë probleme të tilla që s'kena mujtë me veshë çka kena deshtë nifarë forme. Po flas prej vitet '81-ta mrapa.

Ka qenë sigurimi i instalum ktu që i ka përcjellë të gjitha. Fatkeqësisht, po flas, ka pasë edhe bashkëpunorë të tillë mrena, edhe prej shqiptarëve ka pasë bashkëpunorë që jonë kanë t'instalum që kanë bashkëpunu me sigurim t'tillë që kanë dhanë informacione. Po, po flas, shumicën i kena njoftë edhe kena pasë kujdesë të tillë, na qe kena punue. Grupe të tilla kena pasë kujdesë me kon po bashkëpunojmë edhe me kon po punojmë për një interes të tillë.

Unë i falenderoj të gjitha ato gjenerata po flas, me t'vërtetë e kanë dhanë ni kontribut shumë t'madh që shumica e tyre si gjeneratë kanë mujtë me qenë edhe prindër t'mi, që na kanë pritë mirë neve ktu n'punë. Kena bashkëpunu mirë, na kanë edukue me ni frymë realisht na kanë dhanë njohuri, ata na

kanë dhanë shumë njohuri edhe rreth zhvillimit të “Trepçës”, po edhe rreth proceseve kombëtare, “Me kon po rrin? Ki kujdesë. Me kto mos rri. Ky osht’ i përcaktumë knena, ky...”

Domethanë, informacione na kanë dhanë gjeneratat e vjetra, ne si gjeneratë e ri... dhe na gradualisht t’u punu n’rreth, t’u punu n’rreth edhe tash erdh situata, pe dini tash. Vitet ‘88-ta u ngritën pala sërbe t’pakënaqun mrena për mrena në Kosovë edhe bojshin presione, realisht neve shqiptarëve, gjithçka neve na qujshin nashta edhe nivelin ma t’ulët, kanibal e... s’kanë metë domethanë thanje që ekziston n’botë pa na qujtë.

Edhe kena fillu me punu gradualisht ka pak që me i bindë bash me inzhiniera të tillë edhe tash, tash kanë fillu lëvizjet e para. Lëvizjet e para kanë fillu këtu realisht, jena kanë t’pakënaqun, kena mbajtë tubime t’brendshme kur jonë kanë ndryshimet e parimeve themelore të Kushtetutës në ‘74. Une fatkeqësisht e thom me keqardhje që ka pasë edhe akademikë, ka pasë edhe njerëz t’shkollumë që e kanë përkrahë atë iniciativë të Serbisë. Po çfarë forme e kanë përkrahë ata duhet me deklarë vet, jo na realisht, po na jena kanë t’pakënaqun.

Me deklarimet e tyre t’tilla publike jonë dalë, “Jo nuk hupëm na”. Na kena pasë takime ktu në Stantërg të tilla që jonë ardhë njerëzit ma eminent të kushtetutës edhe thojke, “Nuk hupëm na me ndryshimet e kushtetutës”. Edhe na jena çu realisht po flas, s’ka pasë shumë njerëz atëhere edhe punëtorët kanë thanë, “Qysh s’po hupëm? E pse atëhere jonë dhanë kto parime, pse na kanë dhanë kushtetutën e ‘74 nëse s’po hupëm?”

Edhe këtu nashta kanë nisë ato lëvizjet e para kombëtare, mrena në Stantërg po flas. Kanë nisë edhe ma heret, po me dalë n’shesh kështu edhe me kundërshtu politikën kanë qenë vitet ‘88, që kena dalë publikisht edhe i kena kundërshtu parimet themelore. U kanë e para here që u ngritë zëri në Stantërg që i kena kundërshtu. I kena kundërshtu që nuk bon parimet themelore në Kushtetutën e ‘74-tës me u prekë asesi.

Kanë fillu ata, kanë punu realisht edhe strukturat, me ndihmën edhe strukurave tona, kanë qenë njerëz lojal, po flas disa, që i kanë afri serbët, që e kanë përkrahë Serbinë edhe kanë arritë ata deri dikun qëllimet. Edhe qysh me kundërshtu na? Rrugë tjetër s’kena gjetë. U munum me tubime ktu mrena për mrena, nuk mujtëm realisht me arritë qëllimin tonë. Edhe vendosëm me 17 nëntor në ‘88-tën ka qenë marshi për Prishtinë.

Jena shku me mbrojtë ish strukturën udhëheqëse të Kosovës, atëhere ka qenë Komiteti Qendror i Kosovës, që ka qenë Kaqusha [Jashari] dhe Azem Vllasi që i kanë përfaqësu ma tepër, Remzi Kolgeci ka qenë realisht. Edhe jena shku me dhanë ni shtytje, ni përkrahje ish-udhëheqësisë shqiptare që mos me hupë na ata çka e kishim, ato parime themelore shkumë me i mbrojtë realisht.

Anita Susuri: A po ju kujtohet qajo ditë qysh ka ecë?

Shyqyri Sadiku: Po, ajo ditë ka qenë 17 nëntori, '88. Ka qenë në ditë të vështirë realisht po flas, nuk ka qenë ditë e lehtë. Ndrrimi i tretë është nëalë, na ka pritë neve të parve kur keni ardhë edhe ju keni bashkangjitur edhe kërkesat kanë qenë të tilla atëherë, kanë qenë parulla të tilla, "Jugosllavia është e Titos..." Kanë qenë parulla të tilla atëherë, "Po shkojmë më mbrojtë udhëheqësinë e Kosovës, parimet e kushtetutës nuk lejojmë realisht me ndryshu..." Kanë qenë parulla të tilla.

Keni marrë në vendimet bashkërisht këtu që më u nisë për Prishtinë. Keni pasë pasat edhe, edhe represione të ndryshme që kurseu nuk duhej më u nisë për Prishtinë, nuk bon me dalë në rrugë. Keni marrë në vendim të përbashkët. Edhe keni marrë në vendim të tillë të bashkë bashkë minatorët, e vetmja alternativë është rruga. I keni marrë ish flamurit, po flas të minatorëve, të ish-Jugosllavisë, të Kosovës edhe keni dalë në rrugë, edhe e keni marrë fotografinë e Titos. Sistemi ka qenë i tillë. Edhe e keni fillu marshin...

Anita Susuri: Pse e keni marrë fotografinë e Titos, flamurin e Jugosllavisë?

Shyqyri Sadiku: Po ka qenë pasat edhe ai sistemi ish-komunist domethënë që nuk jem në kundër Jugosllavisë shumë, sa jemi në mbrojtje të drejtave të shqiptarëve realisht, qajo ka qenë pasat poenta. Jo që pasat na ka vë shumë, po ka qenë poenta e tillë, se sistemi ka qenë i tillë që, "Nuk jem në me shpërbë Jugosllavinë, po na jem për Jugosllavi po me të drejta të barabarta". Edhe e keni marrë hapin jeni dalë në rrugë.

Kanë insistu atëherë ish-drejtorët, u kanë Burhan Kavaja, ish-drejtor, na ka lutë në formë të ndryshme menaxhmentin mos me dalë në rrugë edhe një gjë të tillë mos te bojmë. Po na kemi qenë këmbëngulës, se e vetmja alternativë ka qenë në rrugë ku na u kanë bashkangjitur edhe ata. Edhe keni fillu marshin nga Stantërgu deri në Prishtinë. Keni pasë pengesa rrugës realisht. Kur jeni shku në Mitrovicë, kanë tentu me na futë në Mitrovicë, realisht si marsh me bo nëpërmjet Mitrovicës, s'keni pranuar asesi. Keni marrë rrugën për Prishtinë. Edhe gjithë kjo rruga e keni kalu këmbë.

Anita Susuri: A u kanë vështirë?

Shyqyri Sadiku: Vështirë.

Anita Susuri: Vështirë u kanë po qysh ju ka dëkë juve?

Shyqyri Sadiku: Po motivi u kanë i madh. Motivi domethënë, gjendja e tillë që është bo keni pasë motiv. Motiv, jo në Prishtinë, po edhe në Shkup ishim shku në këmbë për çështje kombëtare, se ajo u kanë për çështje kombëtare, me i mbrojtë ish-parimet e kushtetutës. Realisht neve e dishim çka po na

pret. Ditë t'mira s'po na presin edhe e murrëm ni hap t'tillë edhe dulëm n'rrugë. Edhe gjatë rrugës na u kanë bashkangjitur edhe qytetarë.

Ajo ka qenë nashta edhe motivi ma i fortë që na ka dhanë energji neve që përkrahës e kem edhe popullin. E kur e kish popullin mrapa realisht edhe qëllimet i arrinë. Kena fillu, jena ndalë në Shupkovc, nuk na kanë pengu. U kanë ai ish... s'di çfarë funksioni ka pasë Bajram Selani atëhere, ish... ni, ni, ni komunist, u dalë në Shupkovc, u hypë me ni kerr nalt edhe na ka apelu që gjithsesi me stopu, mos me shku se, "Osht' rrezik, ka me pasë gjakderdhje..." E gjana t'tilla.

Na jemi kanë këmbëngulës, veç rrugën me na lshu. Na kanë afri tanishi autobusa, me na futë n'autobusa, me na çu me autobusa në Prishtinë. Nuk kena pranë. Shumica, të gjithë të tjerët na u kanë bashkangjitur rrugën edhe kena vazhdu rrugën deri sa jena shku në Mazgit. Kur jena shku në Mazgit jena kanë te ai veni, hala m'kujtohet pishat që jonë ka qenë njësi speciale, bllokun krejt rrugët. Po na e dim që shumica kanë qenë shqiptarë realisht.

Edhe jena afri ngat policie, realisht kanë thanë që na nuk munëm me ju leju me shku ma tutje se e kem urdhërin e prem që duhet me i ndalu se munëm me bo gjakderdhje në Prishtinë, munet me pasë pasoja të tjera. Po fatbardhësisht po flas... kanë qenë edhe shqiptarë të tillë, po na e kemi deviju rrugën. E kena lshu asfaltin edhe dy anë t'rrugës jena da edhe e kena kalu kordonin e policisë.

Kena fillu drejtë marshit për Prishtinë. Në hyrje të Prishtinës u dalë Remzi Kolgeci, ish Kryetari i Komitetit, Kryetari i Krahinës Autonome, i ka pasë po m'doket dy funksione Remzi Kolgeci. Na ka dalë bash n'rafsh atje, ku him qitash në Prishtinë, ku dalim aty n'atë rrafshin, edhe na ka lutë që me u kthy, realisht s'kena pranë. Kena vazhdu edhe kena shku n'palestrën sportive sot që osht', aty na kanë shti, na kanë vendosë...

Anita Susuri: Boro Ramiz.

Shyqyri Sadiku: Po, Boro Ramiz atëhere u qujtë, po. Jena vendosë aty...

Korab Krasniqi: A osht' kjo objekti i vjetër...

Shyqyri Sadiku: I vjetër, po, po, n'qendër...

Korab Krasniqi: A keni shku te salla 1 Tetori?

Shyqyri Sadiku: Ja, ja 1 Tetori atëhere s'ka qenë. Ka qenë veç qikjo palestra sportive ktu, atëhere u thirrë Boro Ramizi. Aty jena vendosë realisht, une i falenderoj qytetarët e Prishtinës që na kanë pritë fantazi. Kena qenë bukur... edhe qytetarët e tjerë na u kanë bashkangjitur rrugës. Jena shku jena vendosë aty edhe aty kanë fillu kërkesat. Kanë folë minatorët, u kanë ky Isuf Tahiri, Avdi Uka e shumë

të tjerë që janë dalë publikisht kanë folë edhe kanë kërku që parimet themelore të Kushtetutës edhe jena ardhë m'i mbrojtë shqiptarët.

N'atë kohë realisht ka qenë Azemi edhe Kaqusha, që kanë qenë nashta krerë n'atë kohë të ish-politikës që e udhëheqëshin në Kosovë. Edhe kena shku me mbrojtë politikën, po ma tepër ka qenë poenta me i mbrojtë parimet themelore të Kushtetutës. Kena diskutu gjatë aty. Jonë ardhë edhe minatorët e Kishnicës na u kanë bashkangjitur. Viti, po, '88. Beso u kanë ni ditë e bukur me diell, edhe ajo na ka ndihmue shumë që e kena marrë rrugën e tillë, që jena shku në Prishtinë, na ka ndihmu shumë.

Dhe kena qëndru me orë të tëra aty, që na kanë sjellë ushqim, po flas banorët e Prishtinës. Kena hangër ushqimin edhe tanishi ka fillu po flas politika me apelin e ish-drejtorëve tonë, "Jo duhet, jo munët me pasë gjakderdhje e sene..." Realisht edhe na minatorët kena marrë vendim m'u kthy. S'paku na kanë thanë që Kaqusha Jashari, "Unë politikë nuk ndryshoj". Ajo na ka garantu si femër ka qenë atëhere e para, po na ka dhanë fjalë shumë bukur t'mdhaja edhe na ka bindë nifarë forme që kena marrë ni vendim të tillë, ju kena kthy. Po, problemet kanë vazhdu, realisht nuk osht' rahat.

Tanishi ka fillu ky marshi i qytetarëve, ajo ka ndodhë po m'doket tri ditë. Ka qenë 17, 18, 19 nëntori që janë dalë qytetarët n'rrugë, janë dalë studentat na kanë përkrahë, edhe ajo ka ndodhë qysh ka ndodhë. Ju kena kthy punës, realisht drejtë me t'hanë punë shumë s'ka pasë. Tash veç osht' bisedu realisht çfarë hapi me marrë tjetër na. Shkumë në Prishtinë nuk mujtëm me arritë qëllimin që e patëm. Prapë politika, politika gjithmonë na ka mashtru realisht.

Edhe dulëm të zhgënjym prej politikës se qaq ka qenë represioni i ish-Jugosllavisë n'atë kohë, i Millosheviqit, prej çdokush duhet me i përmytë shqiptarët. "Shqiptarët duhet me i largu prej Kosovës, janë irredentista, janë nacionalista..." Po s'ka formë tjetër që s'na kanë qujtë...

Korab Krasniqi: M'fal që po t'ndërprejë, kur jeni kthy, domethanë ky ka qenë nifarë reagimi i parë publik i minatorëve karshi politikave t'asaj kohe. Kur jeni kthy mandej a ka pasë persekutime?

Shyqyri Sadiku: Po, kanë fillue.

Korab Krasniqi: Kush i ka organizu kto? A ju kanë përndjekë mrena për mrena...

Shyqyri Sadiku: Qysh jo, qysh jo...

Korab Krasniqi: Çka ka ndodhë?

Shyqyri Sadiku: Qaty kanë fillue realisht, kanë fillu përndjekjet tanishi pakënaqësitë tona vishin veç tu u ngritë. Tash fillojshin me marrë n'pytje, "Kush e organizoi? Kush..." Gjithmonë kanë aludue nga inzhinierët, ka menaxhmenti, që kta janë organizatorë, Burhani me bashkëpunorët e tjerë po flas,

Azizi. Kta jonë tu e organizu realisht, politika e kanë ditë, kanë pasë informacione që edhe politika osht' e kyçne ka pak.

Ata shqiptarë që ja kanë dashtë t'mirën Kosovës po flas, n'atë aspektin, edhe pakënaqësitë kanë fillu, menihere kanë fillu domethanë marrja n'pytje e njerëzve. "Për çka je kanë në Prishtinë?" Domethanë, ka qenë gjithçka kta e kanë pasë nën kontrollë po flas. Sigurimi Shtetnor i ish-Jugosllavisë i ka marrë n'pytje ren krejt, edhe aty kanë fillu pakënaqësitë se fillunë njerëzit mrena për mrena minatorët me i marrë n'pytje.

Edhe tanishi filloj paknaqësia tu u ngritë, ata punojshin tjetrën anë, parimet themelore t'kushtetutës t'i marrnin.

Korab Krasniqi: A ju kanë pytë najsen?

Shyqyri Sadiku: Po na kanë pytë, qysh jo. Gjithmonë na kanë pytë. "Për çka je shku në Prishtinë?"

Korab Krasniqi: Kush...

Shyqyri Sadiku: Ka pasë sigurim shtetnor. Shumicën nuk i kena njoftë. Po t'marrshin edhe u dufshe ti me dhanë deklarata të tilla. Deklaratë u dufke me dhanë të tillë për çka je shku në Prishtinë. "Kush t'ka shty ty me shku?" Se u kanë qëllimi ktu, nashta s'u kanë qëllimi i do individëve, po ka qenë qëllimi i kreut, ose i njerëzve ma eminent ata me i goditë. Po gjithmonë na jena kanë t'përmbajtur n'deklarata të tilla, "Kërkush s'më shtyu, m'shtynë parimet e mija se nuk po du me hupë diçka që kena fitu në '74-tën".

Kto kanë qenë mbrojtjet tona realisht, edhe ka qenë në kohë nashta situatë shumë e ranë. Edhe ma punë shumë pak osht' zhvillu në "Trepçë" sa osht' bo politikë mrena. Edhe aty kanë fillu nashta hapat e parë qysh me u organizue, edhe qysh me dalë sa ma mirë n'realitet që me i mbrojtë kto parime. Na jena kanë t'rrezikum po flas. Fillunë diferencimet edhe nëpër fakultete, fillunë me kërkesa që me i penzionu profesorët me i çu n'penzion të parakohshëm. A neve na goditke realisht, ajo u kanë goditje ndaj institucioneve kryesore.

Kur ta godet ty shkollimin, universitetin, ai po t'godet ty realisht, që qëllimi u kanë që na me i mbrojtë institucionet e Kosovës edhe parimet e Kushtetutës, me lypë diçka që na takon. Jonë kanë ditë të vështira realisht, edhe u kanë realizimi i tillë që na jena marrë vesh e veç ka qenë çështje kohe kur me fillu greva. Kush po e merr atë iniciativë, kush ka guxim të tillë, se kanë hezitu, nuk u kanë lehtë me marrë në vendim t'tillë. Beso, shumë vështirë u kanë.

Po ka pasë grupe që kena bashkëpunu edhe jashtë "Trepçës" që kena bashkëpunu. Po flas, ka qenë gati i përgaditun edhe populli për një gjë t'tillë, po flas edhe studentët edhe... po iniciativë t'tillë s'ka

guxu kërkush me marrë përpos minatorëve. Edhe kena organizu ni gja t'tillë. Edhe po flas, une mburrna për atë punë që e kom bo, me ata bashkëpunëtorë t'mi që kena marrë ni vendim t'tillë. Vendimin e kena marrë për grevë, ka qenë data 18.02.19... sa po i bjen?

Anita Susuri: 1989.

Shyqyri Sadiku: 1989. Po. U kanë data me 18 që e kena marrë ni grup, i kom edhe emnat e shënumë, jena dalë prej ndrrimit të tretë, kena qenë ndrimi i tretë. Jena shku në ni kafe, edhe atë kafe muj me ju tregu, osht' përballë stacionit të autobusave, gati pa shku në Mitrovicë, e kena pasë lokacionin qaty që u takojshëm. Na punojshim për çështje kombëtare. U kanë ni kafe e Pretenit mbiemrin.

Edhe aty jena ulë me qita shokë, nashta najnjo muna me harru se fatkeqësisht do nuk jonë t'u jetu, kanë vdekë. Edhe kena marrë iniciativë të tillë që m'u nalë në grevë me 20 shkurt, 1989 në minierë. I vetmi hap edhe rrugë ka qenë ajo. Edhe atë i kena marrë tri kërkesa jonë kanë të përpilume po flas, tri kërkesa i kena pasë të përpilume. Jonë kanë parimet themelore të Kushtetutës '74 mos m'u ndryshu, e para. Kërkesa e dytë ka qenë mos t'penzionohen pofesorët e universiteteve. Edhe kërkesa e tretë ka qenë, që e kena përpilu na po flas aty, kërkojmë dorëheqjen e këtyre ish tre komunistave. Ka qenë Ali Shukria, Husabedin Azemi edhe Rrahmon Morina, këta tre.

Qito tri kërkesa kanë qenë t'përpilume. Kemi ardhë bashkarisht po flas, kta shokët jonë edhe me emra ktu, nashta osht' mirë ose me i cekë, ose mos me i cekë po qiky gjithmonë ka qenë sekret që kena punu realisht, edhe kurrë nuk jonë zbulu kta njerëz. Po flas nuk jonë zbulu se ka qenë qashtu marrëveshja e tillë që mos me u zbulu. Edhe une jom i mburrun me ata çka kena bo, se kena bo diçka për shtetin.

Jena ardhë, u kanë ditë e hane, kur jena ardhë n'ndrrimin e parë, realisht jena shku, jom ardhë qitu n'banjo, n'zhveshtore kom folë me ni mbikqyrës të horizontit të tetë, u kanë Kurtesh Peci. Ai osht' tu jetu tash jashtë në Gjermani. I kom thanë, "Kurtesh, na kena marrë ni vendim m'u nalë n'grevë. A jeni t'gatshëm me na përkrahë?" Ai u kanë në horizontin e tetë, unë jom kanë në horizontin e nantë. Horizonti i nantë ka qenë bash kryesor, se aty kanë qenë shumica e punëtorëve, dikun 70-80 punëtorë n'ndrrim t'parë punojshin në horizontin e nantë.

Domethanë bartës i tonë ktyne ka qenë horizonti i tetë edhe nantë. Po, po flas n'atë kohë ka qenë horizonti i nantë. Horizonti i nantë m'u nalë në ni grevë të tillë, na besojshum që na përkrahin të gjithë, edhe horizontet e tjera. Kom folë veç me horizont të tetë, pa hi n'minierë po flas, në ndrrim t'parë i kom thanë, "A jeni t'gatshëm me na përkrahë me hi n'grevë?" "Po", m'ka thanë, "Jem t'gatshëm".

Edhe kena komuniku po flas realisht, jena shku poshtë na, qiky grup {tregon me gisht drejtë emrave në fletë} shumica po flas jonë kanë në ndrrim që kena punu bashkë edhe e kena marrë ni vendim t'tillë m'u nalë. Kur jena ardhë n'fund t'ndrrimit, e kena kry punën n'ora 01:00, s'jonë dalë. Edhe kërkesat

kanë qenë t'tilla. M'kanë thirrë n'telefon, m'ka thirrë inzhineri Beqir Maliqi, sigurisht keni bo intervistë edhe me to...

Anita Susuri: Jo...

Shyqyri Sadiku: Po, keni bo. Beqir Maliqi.

Korab Krasniqi: Po, po.

Shyqyri Sadiku: Mu m'ka thirrë n'telefon edhe tha...

Anita Susuri: Aaa, po, po, po.

Shyqyri Sadiku: Ky ka qenë drejtues i minierës n'atë kohë.

Anita Susuri: Tash osht' zavendës...

Shyqyri Sadiku: Tash osht' drejtor teknik. Edhe m'ka thirrë, "Shyqë, çka osht' problemi?" I kom thanë, "Çka të intereson, hajde poshtë". Se nuk kom dashtë me bisedu përmes telefonave realisht po flas. Komunikimi përmes telefonave të tjerë induktiv që janë në minierë me horizonte tjera e kom autorizue ni parapunëtor timin. I kom thanë, "Komuniko me horizont..." Se horizonti i dhetë ka ardhë natën na u ka bashkangjtitë. Horizontin e tetë veç u murrëm vesh n'fillim që m'u nalë ata. Edhe e kom shti me komuniku me horizontin e shtatë, gjashtin, t'pestin, katërtin edhe t'tretin. Edhe të gjithë janë kanë dakord, edhe ka fillu greva.

Po flas m'ka thirrë ish drejtuesi i minierës Beqir Maliqi m'ka thanë, "Shyqë, çka osht' problemi?" I thashë, "Çka t'intereson, hajde poshtë". Edhe komunikim tjetër shumë s'kena pasë. Ka fillu greva realisht, osht' shpallë greva. Edhe i kanë caktu tash po m'doket realisht prej s'jashtit i kanë caktue inzhinierët nëpër grupe me ardhë nëpër miniera edhe me na lutë me dalë jashtë. Realisht, po flas në horizontin e nantë ka ardhë n'atë kohë prej inzhinierëve, ka qenë drejtor teknik Ibush Januzi. Ka qenë kryetari i sindikatave të punëtorëve Smajl Limani edhe ka qenë ni serbe, ka qenë kryetare e Partisë Komuniste, Luljana Gashiq.

Jonë ardhë n'horizontin e nantë. Jena ulë kena bisedu realisht. Po une po thom fatkeqësisht ka pasë punëtorë të tillë edhe atëhere që janë kanë punëtorë të tyne, që s'ju kanë bashkangjtitë grevës. Po i kem t'njohun ata, po le t'jetë n'ndërgjegjën e tyne. Po, po flas 99 përqind të shqiptarëve ju kanë bashkangjtitë grevës edhe ka fillu një grevë e tillë.

U ardhë Ibushi me ekipin e vet edhe kena bisedu, edhe Ibushi realisht na u ka lutë me dalë prej miniere edhe me kqyrë... ka thanë, "Kërkesat e juve cilat janë?" I kena thanë... kërkesat janë kanë qato tri

kërkesa po flas, po i potencoj edhe ni here, që ja kena thanë publikisht, “Kërkesa osht’ parimet themelore të Kushtetutës nuk ndrrohen. Mospenzionimi i profesorëve të universitetit të parakohshëm nuk pranojmë, edhe dorëheqjen e Ali Shukrisë, Rrahmon Morinës edhe Husabedin Azemit. Këto janë kushtet elementare që duhet me u plotësu për me dalë na nga miniera.

Kena fillu grevën, e kena shpallë grevë urie, ka qenë grevë uri. Ka qenë vendim realisht i vështirë me marrë, nuk ka qenë i lehtë. Edhe kanë fillu tanishi edhe këshillet greviste me u formu mrena për mrena atje. Gjithkush i ka pasë detyrat e veta. Dikush u kanë me dalë para mediave, me prononcime t’tilla, sene. Unë i falenderoj n’këtë rast edhe gazetarët që kanë qenë shumë t’rreptë, kanë ardhë gazetarët shqiptarë realisht, që edhe kanë shpërnda n’opinion të përgjithshëm fillimin e grevës. Edhe na kanë nimu drejtën me t’thanë, se pa gazetarë, pa opinion të tillë na s’kishim mujtë realisht me bo.

Po gjithsesi n’këtë rast i falenderoj shumë edhe studentat edhe gjithë popullin shqiptarë, se ata kanë qenë nashta dora e djathtë, e krah i djathtë që na kanë shty me qendru n’minierë, se na kanë përkrahë në forma t’ndryshme po flas. Edhe kanë fillu nashta edhe destabilizimi nashta po flas edhe n’nivel të Kosovës, kanë fillu edhe grevat të studentëve. M’kujtohet edhe në Fakultetin Xeharo-Metalurgjik kanë fillue, edhe në Prishtinë. Edhe ajo nashta ka qenë përkrahja jonë ma e fuqishme najherë n’histori. Që kanë fillu tanishi kërkesat, kanë fillu janë rritë kërkesat, janë shku deri nimdhetë kërkesa.

Sot i keni edhe n’libra të tilla t’shkrume që kanë qenë kërkesa edhe kërkesa e fundit po m’dukët ka qenë që problemi i Kosovës të zgjidhet në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkume. Edhe e kena ditë na realisht, na kena qëndru stoikisht, kena qenë shumë unik. Nuk ka qenë lehtë, po flas n’realitet me nejt tetë ditë n’minierë n’kushte t’vështira.

Anita Susuri: Qysh janë konë qato ditë, çka po t’kujtohet ma shumë prej qatyne ditëve?

Shyqyri Sadiku: Po, të vështira kanë qenë realisht ato ditë. Tash me e kthy mrapa filmin, kanë qenë të vështira për t’gjithë neve, po flas, se nuk u kanë lehtë po flas. Për mu nashta u kanë ma lehtë, se une në fund të fundit se une s’kom qenë i martumë, s’kom pasë familje realisht, i kom pasë prindët e të tjerët. Po aty shumica, 90 përqind kanë qenë njerëz familjarë, që kanë pasë fëmijë, kanë pasë t’martum gra. Realisht nuk u kanë lehtë për prind me u fliju n’ato situata.

Une po thom, realisht s’e ka ditë kërkush a munët me dalë a s’munet. Qaty u kanë esenca, problemi krejt, a munët me dalë i gjallë, a s’munët? Edhe qaq jena kanë unik po flas, qaq jena kanë kompakt që jena kanë t’gjithë për njo, ose ni për t’gjithë. Edhe ajo ka qenë po flas tash edhe besa e minatorëve u kanë, që jena kanë t’betum për qata, se po kom pak emocione (i dridhet zëri) me kthy filmin osht’ pak e vështirë (qanë).

[Ndërprietet video-intervista]

Edhe realisht, po, filloi greva e tillë. Po flas mburrem prapë, edhe një here po e thom, me ata njerëz, kanë qenë heronjë të Kosovës, qujë çka dushë, se nuk u kanë lehtë për ta me marrë ni vendim t'tillë. Vendimi u kanë ose t'gjallë, ose t'vdekun nuk dalim realisht pa u realizu kërkesat tona. U kanë, ka pasë edhe këshille greviste që jonë kanë ma t'ashpërta, të tilla. Kena pasë plan nashta edhe... eksplozivet jonë kanë mrena edhe ka pasë tendenca të tilla me minu minierën edhe t'gjallë mos me dale prej minierës.

Po flas kohën, periudhën kur erdh ish drejtori Ibush Jonuzi me ish kryetarin e sindikatës edhe ata na lutën n'forma t'ndryshme realisht me dalë, po na i kishum përcaktimet edhe qëndrimet tona që asesi nuk dalim. Edhe kjo ka përfundu realisht, ju kena thanë, "Ju e keni rrugën çelë, muni me vazhdu edhe mos me na pengue n'punën tonë, realisht n'grevën tonë". Jonë pajtu nifarë forme po flas edhe ata. Tash nashta nuk osht' edhe mirë me potencu që kur e panë këmbëngulsinë tonë që jem realisht unik edhe t'lidhun.

Këtij drejtorit teknik i pat ra edhe t'fikt, Ibush Januzit, e kena qitë realisht deri te pusorja edhe tashi ka fillu greva. Tash u ardhë ndrrimi i dytë na u ka bashkangjitë n'grevë që ka pasë tentativa me i pengu realisht, po s'kanë mujtë, jonë hi edhe ndrrimi i dytë, na u kanë bashkangjitë n'grevë, edhe greva ka fillu. Po flas, tash masovike, se jena kanë veç ni ndrrim, ndrrimi i parë, tanishi u ardhë ndrrimi i dytë edhe ndrrimi i tretë. Edhe tanishi jonë ardhë edhe tjerët që kanë qenë n'pushime, jonë ardhë te gjithë.

Kena bo grevë masovike që jonë kanë t'përfshim dikun 1200-1300 minatorë në grevë. Po shumica jonë kanë t'përqendrumë në horizontin e nantë, horizontin e tetë. Nashta edhe bash kryesor kanë qenë, po me t'vërtetë kushtet atje shumë t'rana, t'vështira se ka mungu edhe ajrimi. N'ato kushte ka mungu edhe pastërtia edhe gjithçka realisht, po jena kanë këmbëngulës, se kena pasë ni ideal. Ideali jonë ka qenë që kërkesat tona të realizohen. Edhe ajo na ka ndihmu shumë.

Anita Susuri: Ju keni pasë edhe shumë vizita edhe prej delegacioneve t'ndryshme edhe gazetarëve...

Shyqyri Sadiku: Po, shumë.

Anita Susuri: ... politikanë. Do po m'dukët nuk i keni pranë disa, qysh ka qenë ajo?

Shyqyri Sadiku: Po, realisht po, disa gazetarë nuk i kena pranë. Tash çka kanë qenë gazetarë që e kena ditë që kanë qenë të Radio-Televizionit Serbisë nuk i kena pranë realisht, se e kena ditë propaganda e tyre çfare osht'. Na i falënderojmë gazetarët e Radio-Televizionit të Prishtinës atëhere, që kanë qenë gazetarë po flas edhe me emër. Nashta ka qenë edhe Halil Matoshi edhe ky Blerimi, që osht' këshilltarë i presidentit tash.

Korab Krasniqi: Halil Matoshi edhe?

Shyqyri Sadiku: Edhe Blerim... që e ka pasë edhe në gazetë, tash këshilltarë i presidentit osht' ai, që e marrke n'bisedime edhe ish presidenti Rugova.

Anita Susuri: Po, edhe?

Shyqyri Sadiku: E falendëroj, ka qenë edhe gazeta, gazetarët e Kroacisë që i kanë dhanë publicitet t'madh, edhe sllovenët, sidomos sllovenët. Gazeta sllovene na ka ndihmu shumë n'realitet, bashkë me tonët, po i kanë jep publicitet edhe e kanë përhapë grevën nëpër botë realisht. Mos me pasë qenë edhe mjetet e informimit, po flas, me zbardhë këtë rast, këtë grevë madhështore u kanë vështirë me dalë jashtë.

Por, t'u ju falenderu gjithmonë po flas edhe studentave edhe gjithë popullatës kosovare që kanë qenë përkrahës tonë, edhe ajo na ka dhanë energji edhe fuqi që na me qenë edhe ma kambëngulës n'kërkesat tona. Ka qenë në grevë shumë e vështirë realisht po flas. Ka pasë njerëz që i fullunë edhe pasojat shëndetësore me i rrezikue. Po kursesi nuk lejojshim me dalë jashtë Stantërgut edhe kontrollimi mjekësor, tu ju falenderu edhe stafit mjekësorë atëhere në Mitrovicë.

Na kanë nimu edhe qytetarët realisht, e kena bo improvizimin e stacionit shëndetësorë salla ku osht' që mahen tubimet e punëtorëve edhe ka qenë kjo ndërtesë. Atëhere u kanë n'fazën e përfundimit, meremetimit, e kena bo si stacion shëndetësorë. Të gjithë ata që kanë pasë nevojë për ndihma shëndetësore edhe për shtrirje, e kena bo improvizim të spitalit ktu. U kanë edhe stafi shëndetësorë i kompletum, i falenderoj edhe ata të gjithë, stafin shëndetësorë...

Korab Krasniqi: Kush ka qenë...

Shyqyri Sadiku: Kanë qenë shumë mjek po flas tash në, në... me emra...

Korab Krasniqi: A t'kujtohen?

Shyqyri Sadiku: Nashta najnjo m'kujtohet, po realisht tash s'po muj me thanë se qe m'kujtohen ti shkruj n'telefon t'i çoj. Kanë qenë shumë mjekë që na kanë përkrahë, u kanë Sami Beqiri po flas n'atë kohë doktorri. Kane qenë edhe kta doktorrtë tonë ktu. Shumë të tjerë që na kanë përkrahë, po edhe motrat medicinale po flas, kanë qenë gjithë afër neve. Teknikët medicinal, domethanë të gjithë... gjithçka që kena pasë nevojë na kanë ofru për shërim.

Edhe filloi tanishi numri tu u rritë i të sëmurëve nga miniera, po të gjithë jemi kanë t'shtrimë... po flas si pjesë, edhe une mas gjashtë dite jom kanë pjesë e qatij stafit, po flas të improvizum, stacionar... jom kanë i shtrimë n'spital për shkak t'shëndetit që e kom pasë... domethanë ma s'tepërmi kemi pasë

probleme me kamë, se s'kishim ku me i pastru kamtë të tilla e me çizme. Edhe teshat n'punë kena pasë probleme të tilla.

Dhe e dini tash ni histori që zgjatet tetë ditë. Ka pasë delegacione t'ndryshme. Ka pasë delegacione edhe ka qenë n'minierë Azem Vllasi, na ka vizitu, na ka lutë edhe ai... s'po flas për kta eprorët tonë absolutkishit që kanë qenë kambëngulës. M'kujtohet ni rast Aziz Abrashi, e ka pasë ni djalë, tha, "Dorën pranoj me pre veç ju me dalë". Po s'kena pranë realisht. I kemi thanë, "Nuk pranojmë ni gjë t'tillë".

Po une i falenderoj edhe ata për përkrahjen dhe bashkëpunimin që na kanë dhanë. Se mos me kanë edhe ata me na përkrahë realisht u kanë vështirë me i shty proceset, po ata kanë qenë n'qat vi, po ata publikisht s'kanë mujtë me thanë që duhet me i përkrahë. Po realisht kanë qenë edhe ata nashta për motorr që i kena lëzivë këto procese bashkarisht. Kanë qenë shumë delegacione në minierë, po delegacione kena pasë kujdesë kon p'e lshojna n'minierë. Delegacione që e kena ditë që nuk janë në interes të kërkesave tona dhe në interes të Kosovës nuk i kena panu. Nuk i kena leju as me hi mrena.

Ka pasë m'kujtohet, ka qenë edhe gruaja e Azem Vllasit, Nadira Vllasi ka qenë gazetarë po m'doket e "Danas-it" u konë atëhere, që u ardhë e dhe ajo n'minierë, na ka vizitu, nashta hapin e parë që kena fillue të, të grevës, ka qenë edhe ajo. Ka marrë intervista të tilla të shumta. Edhe ajo na ka ndihmu shumë po flas, uniteti, uniteti i mrenshëm që ka qenë bashkë... se ma nuk ka pasë realisht, kur u murrë vendimi u formun këshillat, ma s'ka pasë drejtorë edhe punëtorë, por jena kanë një t'gjithë. Edhe ajo na ka ndihmu shumë.

Po na ka ndimë shumë edhe përkrahja e studentave edhe e qytetarëve të Kosovës. Ata janë kanë nashta mbshtetja edhe shtylla janë kryesore që na kanë shty. Ka pasë vizita edhe prej qytetarëve, prej akademikëve të Kosovës na kanë vizitue realisht, prej delegacioneve t'ndryshme. Ka qenë edhe ish këngëtarja e famshme Shkurte Fejza. Po kanë qenë edhe shume delegacione tjera. Kanë qenë delegacione t'studentave edhe shumë të tjerë. Po gjithmonë që na kanë përkrahë.

Edhe ka zgjatë kjo grevë e dini, tetë ditore. Nuk u kanë lehtë tetë ditë me nejt n'minierë. Ka njerëz që tetë ditë kurrë nuk janë dalë prej miniere. Po flas edhe une jom kanë pjesë e saj, une mburrem që kom qenë pjesë e saj, një historie t'tillë, a din. Po nuk u kanë lehtë tash realisht, edhe komunikimi me familje atëhere s'ka pasë realisht, s'kena mujtë me komuniku, e keni ditë te tanë po... na jena kanë t'përcaktum për ni ideal. Ideali ynë ka qenë ky, me u ru Kosova realisht, me u ru parimet themelore tv Kushtetutës, mos me u penzionue profesorët e univeritetit. Po ata që kanë qenë bashkëpunëtorë të Serbisë me u hejë prej skenës politike. Ai ka qenë ideali jonë.

Une i falenderoj të gjithë, po flas edhe ni here, edhe inzhinierët, stafin menaxhues, përpos disa individëve që kanë qenë... edhe inzhinierë ka pasë që kanë punue kundër ktyne kërkesave. Po shumica kena qenë t'bashkum, i falenderoj të gjithë stafin, tu u nisë, po flas prej ish menaxhmentit ose

drejtorëve të “Trepçës”. Edhe i falenderoj edhe studentat, i falenderoj edhe popullin shqiptarë që na kanë mbështetë n’këtë rast. Edhe ajo ka qenë nashta motivi jonë që na ka majtë mrena shumë. Na kanë përkrahë n’forma t’ndryshme.

Korab Krasniqi: Zoti Shyqyri, deshta me ju pytë për kur keni kërku mos largimin prej funksioneve të Kaqusha Jasharit edhe të Azem Vllasit, po ka qenë edhe ni emër tjetër tjetër në mesin e tyre. A t’kujtohet kush ka qenë? Pra ju keni kërku mos me përjashtu, mos me largu prej funksionit Kaqusha Jasharin, Azem Vllasin. Ka qenë edhe ni emër tjetër, a po t’kujtohet?

Shyqyri Sadiku: Nashta kom harru.

Korab Krasniqi: Osht’ Svetislav Millosheviq, a po t’kujtohet kush ka qenë ky person?

Shyqyri Sadiku: Jo, absolutikisht jo. Nuk e di edhe kush ka kërku. Po une po flas si emna që i kemi potencu na, jo nashta edhe që kanë dhanë shumë po flas, po jonë kanë njerëz eminent që s’paku kanë mendu diçka për shqiptarë mirë kanë qenë Kaqusha Jashari. Une e falenderoj publikisht që ajo për herë t’parë ka folë shumë fjalë t’mdhaja, n’atë kohë nuk u kanë lehtë më folë Kaqusha, si ni femer e tillë që na ka dhanë përkrahje t’tilla, edhe Azem Vllasi. Se na u duftë dikun me u mbështetë n’disa figura politike të Kosovës, s’pakti që kanë dhanë diçka për Kosovën për me mbështetë na. Se na s’kena lypë mbështetje as të Rrahmon Morinës, as të Remzi Kolgecit, se edhe Remzi Kolgeci ka lue, me dy lojna e ka lue, edhe ai nifarë politike t’keqe e ka lue. Po do shqiptarë çka kanë qenë ma eminent n’atë kohë po flas, po përgjegjës kanë qenë... për ata nuk e di, nuk jom njohuri, besa as si emër s’po m’kujtohet.

Korab Krasniqi: Ktu e kemi gjetë në arkiva, ku osht’ raportu kërkesa qashtu...

Shyqyri Sadiku: Po de, bon vaki. Une nuk jom i njoftum realisht. Une për herë t’parë po e ni edhe këtë emër po flas. Po jena kanë t’fokusum realisht... po kta bashkëpunorët tonë t’mrenshum që jonë realisht që kta me i largu prej politike, mos me, mos me, mos me na kriju dame. Edhe ka fillu greva të tillë edhe... tash m’kujtohet mirë kur u ardhë n’grevë, jom zhdjergjë une kur u ardhë Stipe Shuvari. Ka qenë kërkesa jonë me ardhë para minatorëve Slllobodan Millosheviqi me gjithë kta politikanët.

Nuk ka qenë guxim ai me ardhë, u çu ka ardhë, ka organizue në Fushë Kosovë atje, ka organizu protesta të tilla atje tash kundër shqiptarëve. I ka ngritë minierat n’pjesën veriore te Leposaviqi që jonë kanë t’dominume nga serbët, i ka ngritë në greva të tilla kundër shqiptarëve, kundër grevës tonë. Edhe erdh ni situatë shumë e vështirë edhe e ranë. Edhe na i kërkonim Millosheviqit të vjen në Stantërg, të vjen para minatorëve edhe të deklarohet pse po e bon gjithë këtë represion kundër shqiptarëve, pse po ja u merr këto t’drejta shqiptarëve, çka i kem borxh na atina realisht.

Ai nuk ka ardhë, përkundrazi ka realizu protesta të tjera. Në Stantërg osht' ardhë Stipe Shuvari, ish kryetar po m'doket i Komitetit Qëndror të ish Jugosllavisë atëhere, me Radisha Gaqiqin, ai ka qenë diçka n'funksion nga Serbia. Kanë ardhë në horizontin e tetë. Që jonë t'inqizume, n'arkiva e keni t'rujtun edhe bisedimet kur ka bisedu ai Murseli, Mursel Haziri, ish teknik i xehtarisë. Kanë bisedu Avdi Uka e shumë të tjerë që jonë kanë njerëzit e caktum për informim edhe për biseda të tilla realisht, me u prononcu.

Edhe Stipe Shuvari na ka lutë realisht n'forma t'ndryshme që me lshu minierën, po s'kena pranë. Po realisht e vetmja kërkesë ka qenë s'pakti këto tri kërkesa me u përmbushë, për të tjerat bisedojmë. Edhe e dini situata qysh na ka ndodhë realisht, edhe na kanë garantu që parimet themelore të Kushtetutës s'kanë mu ndrru, e kena lypë me shkrim. Dorëheqjen e Rrahmon Morinës, Ali Shkurisë edhe Husabedin Azemit na kanë ardhë më shkrim të vulosta. Edhe mos penzionimi i profesorëve nga fakulteti na kanë ardhë t'gjitha të tilla.

Edhe atëhere na kena marrë ni garanci që kërkesat tona po plotësohen. Po ky ka qenë një mashtrim i tillë. Po flas, kur ka qeshë Stipe Shuvari dhe Radisha Gaqiqi n'horizontin e tetë, Stipe Shuvari na ka lutë realisht, tha, "Edhe prindin e kom pasë xehtar e sene, ju lus me dalë prej miniere se nuk zgjidhën problemet ktu. Po nuk jom ai që ju zgjidhi problemet". N'fund na ka thanë, "Nuk jom ai që i marr vendimet përfundimtare për kërkesat e juja".

Po ma n'fund po flas, n'ditën e tetë na kanë ardhë që kërkesa t'tilla që jonë realizu kërkesat tona. Edhe ka fillu domethanë dalja e punëtorëve nga miniera. Me fillu daljen e punëtorëve nga miniera ni pjesë që kanë qenë këto spitalet e improvizume, edhe salla, edhe kjo ndërtesë.... Fillojnë punëtorët kanë dalë, kanë dalë n'mramje po m'duket, ditën e tetë n'mramje kanë fillu me dalë. Edhe realisht aty kanë fillu tanishi kur jonë dalë prej miniere e kanë blloku minierën edhe tanishi kanë fillu represionet po flas.

Represionet nashta ma ç'njerëzore po flas, që kanë fillue, i kanë pru njësitë speciale prej ish Jugosllavisë krejt edhe u kanë në shtet-rrethim miniera krejt. Kanë fillu njerëzit me lëvizë pak, me dalë. Jena metë ni pjesë që jena kanë t'sëmurë mrena, ditën e tetë, edhe tetën kena nejt ktu, kena bujtë krejt. Ditën e nantë u ardhë, u kanë komandir i stacionit policor në Stantërg, Fahri Ibishi, u kanë me nifarë Kandiçin, u kanë zëvendës i tij. Edhe kanë ardhë na kanë lutë realisht me dalë, me lshu sallën se u shpallë gjendje e jashtëzakonshme në ish Jugosllavi edhe duhet me liru objektin e sene se...

Anita Susuri: Ti je kanë qaty a?

Shyqyri Sadiku: Jom kanë po, po. I shtrim jom kanë.

Anita Susuri: Çfarë lëndime...

Shyqyri Sadiku: Lëndime kom pasë probleme me veshkë edhe me kamë, po. Na ka lutë realisht edhe na s'kena pranë asesi me dalë. Kena thanë, "Jem t'smutë, nuk mujëm me dalë". Na kanë prue ekipin mjekësor nga Mitrovica, se filloi represioni, tërhiqën mjek, i largun krejt. Na prunën kontrollimin mjekësor edhe thojshin mjektë, na bojshin raportin çdonjanit prej çkafit lëngon, ku duhet me shku, që gjithsesi u dufke me lshu ktu realisht. Që n'atë pjesë t'atij procesi po flas që u kanë sallë e... po flas stacionar i improvizum, ka qenë edhe Avdi Uka, pjesë që kena qenë bashkë aty.

Edhe fillun represionet edhe na thanë që t'gjithë që duhet me lshu, na luti ky farë lbishi tha, "Ju lutem, duhet me lshu se gjendja osht' e tillë, une po ju flas, po ju luti n'forma ma t'ndryshme". S'kena pranë realisht, s'kena pranë me lshu. Edhe ditën e nantë jonë hi njësia speciale, forca t'ndryshme që jonë ardhë prej ish Jugosllavisë edhe na kanë largu t'gjithëve.

Na kanë largu krejt ktuhit, me dhunë na kanë qitë, na kanë qitë jashtë, edhe atëhere kanë fillu represionet po flas, gradualisht kanë fillu burgosjet. Kanë fillu burgosjet e ish udhëheqsisë të "Trepçës" në krye me Aziz Abrashin, Aziz Abrashi e të tjerët, që osht'... 14 të ish të akuzuarit n'kry që ka qenë edhe Lazer Krasniqi, ish drejtor i KEK-ut që ka qenë. Edhe ai u kanë i përfshim n'këtë pjesë edhe situata ka arritë e tillë. Neve na largun prej pune nihere krejt.

Miniera realisht u mbyll n'atë kohë, nuk funksionojke edhe gjendja e jashtëzakonshme u shpall në Kosovë. Tanishi fillunë edhe demonstratat, mas asaj kohe po flas. Pakënaqësia u ngrit, fillunë protestat e ndryshme, domonstratat e tilla. I burgosën kta, krye me Azem Vllasin edhe të tjerë. Paknaqësia shumë e madhe, revolta ishte shumë e madhe. Fillunë tanishi edhe marrja n'pytje e të gjithë neve. Po flas që kena kalu nashta edhe ditë t'vështira, s'jonë kanë ditë t'lehta për neve.

Anita Susuri: A t'kanë marrë n'pytje edhe ty?

Shyqyri Sadiku: Po, qysh jo.

Anita Susuri: Qysh ke? Çka t'pytën a?

Shyqyri Sadiku: Gjithçka m'pytshin realisht. "Qysh ka fillu? Kush e ka organizu grevën, kush ka pri realisht?" Po gjithmonë, kena qenë t'betum na si grup, pavarësisht, çdonjani që t'merr [në pyetje] që nuk guxon kërkush me u zbulu. Prej ktij grupit... se tendencat krejt ishin m'u kanalizim ka ish udhëheqësitë e "Trepçës", ish udhëheqësitë e politikës në Kosovë... adresimi osht' domethanë krejt i Sigurimit Shtetnor sërëb që kanë adresu domethanë ata me i akuzu, që ata na kanë nxitë, që ata na kanë shti realisht që nuk ka qenë qashtu.

Unë ju thojsha, "Ky ka qenë një organizim spontan, kjo ka qenë marrëveshje e punëtorve realisht". "Pse s'je dalë ti prej miniere?" M'thojke. "Po nuk kom të drejtë une me dalë prej miniere, se une jom udhëheqës i tyne. Une pa ta nuk guxoj me lshu minierën, edhe une jom pjesë e tyne". "A i ke

përkrahë?” “Po, i kom përkrahë realisht”. Edhe i përkrahi edhe sot, ka qenë ni kërkesa reale edhe e arsyshme. “Jo, ju kanë shti drejtorat”. “Drejtorat s’na kanë shti absolutikisht, na jem t’vetëdijshtëm n’diçka çka e bojme”. Une nuk jom i ri, n’moshën 25 vjeçare atëhere. Une jom i vetëdijshtëm çka boj e çka veproj.

Organizatorë s’ka pasë, organizatorë kanë qenë t’gjithë minatorët. “E kush jonë ata minatorë?” Thojsha, “Jonë 1300 minatorë që kanë qenë pjesë e grevës, ata kanë organizu”. S’ka pasë individë aty që e kanë organizu. Jena marrë bukur shpesh n’pytje. Kena pasë kërcnime, kena pasë shantazhe. Drejtën me t’thanë tash osht’ keq që i kanë ngritë edhe revolet ish sistemi, “Jo kem me ju vra, jo kem me ju likfidue, jo kem me ju pushkatu...” Po realisht nuk na kanë trishtu ata kërcnimet e tyre realisht se motivi edhe ideja jonë e kena ditë çka osht’ e drejta jonë.

Ato kanë qenë kërcnime dhe shantazhe t’tyne po s’jena përlulë kurrë ndaj ish anëtarëve t’tyne. Edhe po flas ka qenë nashta periudha ma e ranë në histori të Kosovës, që ma s’shumti njerëz jonë persekutu, jonë marrë n’pytje, jonë burgosë, jonë dënu. Të gjithë kta minatorë që kanë qenë pjesë e grevës, t’gjithë kemi qenë t’dënum s’pakti ni mujë, dy mujë, tre mujë burg prej ish sistemit domethanë. Edhe ajo ka qenë nashta koha ma e vështirë po flas për minatorët e “Trepçës”. Po osht’ krenari që i kena pasë ata njerëz n’atë që ka qenë unik, edhe kanë qenë kompakt.

Tanishi ka fillue, po flas mas burgosjës t’tyne ka fillue me i thirrë njerëzit n’punë ktu, jonë kanë thirrjet ushtarake. Krejt thirrje ushtarake kena pasë për me u kthy n’punë. I thirrshin pjesë-pjesë, grupe-grupe që mos me u grubullu ma shumë. Me kqyrë qysh po veprojmë ktu mrena realisht. Tanishi pas ni kohe jena kthy shumica, do hale s’jonë pa kthy. Tanishi ka fillu edhe ni grevë e dytë që ka qenë dikun prej 60 vetëve që jonë nguju n’minierë (kollitet). Ata e kanë pasë pak ma vështirë nashta se ajo greva e parë se kanë qenë ni pakicë ma e vogël edhe asni trohë ushqim, as ujë s’ju kanë lshu.

Edhe ka qenë nashta ni goditje e dytë e ranë për minatorët e tillë që jonë hi njesia speciale i kanë nxjerrë me dhunë. Edhe krejt i kanë lidhë edhe i kanë dënu me burg, të tilla kanë qenë. Po kjo ka qenë historia e tillë po flas, e grevave të tilla, edhe ma “Trepça” po flas nuk ka pasë rehati, nuk ka pasë qetësi.

Pjesa e Katërt

Anita Susuri: A kthyt tani në punë? A jeni kthy në punë?

Shyqyri Sadiku: Pavarësisht, po jemi kthy në punë, po punë s’ka pasë. Punë s’ka pasë realisht, jena ardhë sa për sy e faqe po flas, se punë rezultate në punë s’ka pasë, se tanë jena kanë të deshprumë me tradhëtinë që na e bonën, me politikat që vazhdonë të tilla kundër shqiptarëve... dhe realisht po thom, fillunë edhe, edhe... ju e dini edhe protestat, demonstratat fillunë. Kanë fillu në vitin ‘89. Kanë

qenë demonstrata masive që ka pasë njerëz që janë vra. U vra ky Vojvoda... këtë urën e Mitrovicës na e kemi çelë prej demonstratave, punë s'ka pasë.

Unë po flas shumë herë jom ardhë me puntorë në ndërrim të dytë ose të parin. Kur ka pasë demonstrata, na s'jemi hi në punë, ju kemi bashkangjitë në demonstrata jemi shku. Realisht, se percaktimi jonë ka qenë anena. Edhe fillun tash, realisht p'e dini... burgosje të tilla, marrje, kanë qenë shumë situata të rana dhe shpresat tona nifare forme u mundun me na i fundosë. Po realisht, neve na bonën ma të fortë po flasë, në atë aspektin kombëtar, se si shqiptar u bashkumë nashta historia, najherë në botë në mend s'ka me majtë qysh kanë qenë unik shqiptarët në vitet '88, '89, '90 po flas. Historia kurrë s'ka me majtë në menë.

Kena bashkpunu, aktivitetet bashkë i kena zhvillu. E panë realisht qe ndodhi një gjë e tillë dhe në vitin '90 fillunë me diferencimet prapë realisht. Edhe erdh puna edhe na u lirunë Azizi edhe Burhani edhe kta prej burgu edhe na insistumë me i kthy si drejtora, se u lirunë si të pafajshëm. Insistumë palët tash po flas, politika nuk i lejojke. Tash më duhet me thanë ishin shumë drejtora të zorshëm kanë qenë këtu. Situata të tilla që kanë qenë të padëshirushme për neve. Mos të flas, ka pasë edhe shumë greva dhe protesta të tjera pas grevës madhështore nëpër banjo, nëpër restorane, kto që jena kanë të pakënaqun realisht, shumë here. Jena nguju edhe një herë në restoran e kena bo protesta të tilla po asnjëherë s'kena mujtë... nashta ato dëshirat në realizimin tonë me bo, në kontekst të qasaj shtate po flas. Gjithmonë e kena pasë një shpresë. E kena pa një, një dritë në fund të tunelit që një e ardhme ka me qenë.

Edhe erdh ma në fund, po flas vitet e '90-ta na largunë prej pune krejt. Masovikisht. Ka qenë 8 gushti [1990], kur jena ardhë me hi në punë në ndërrim të parë, u kanë krejt e bllokume me njësi speciale, të ndryshme ktu. Edhe na kanë thanë me i pranu kushtet e Serbisë. Autonomia është marrë, duhet me hi me fillue me punue si provincë e ish-Serbisë po flas për Kosovën, atëherë s'kena pranu realisht një gjë të tillë. Edhe aty na kanë shëputë marrëdhaniën e punës, na kanë largu krejtve prej pune. Para neve është largu prej punë po më duket gazetarët e "Rilindjes" e kanë mbyllë edhe Policia e Kosovës.

Po na e dimë me datën 8 gusht ka qenë dita e fundit që jom ardhë në punë në atë periudhë, edhe ma s'kemi punu deri mas lufte.

Anita Susuri: Prej të '89-ës domethënë...

Shyqyri Sadiku: '90-ës.

Anita Susuri: '90-ës.

Shyqyri Sadiku: '90-ës. Me 8 gusht jena kanë të largumë na shqiptarët prej pune. Në mënyre masovike. Unë s'po thom që s'ka pasë individë të tillë që kanë punue, po ata kanë qenë pjesë e tyre. Po 89 përqind e shqiptarëve jonë largu prej pune. Domethanë, kanë fillue me "Rilindjen", kanë fillu me minatorë, kanë fillu me polici. Tash ju e dini lëvizjet mas '90-ës qysh kanë fillu...

Po tash filloi edhe organizimi sindikal në qatë kohë po flas... është organizue sindikata... për herë të parë një sindikatë e pavarur e minatorëve të “Trepçës”, në kuadër të minatorëve, që e zgjedhëm kryesinë edhe kryetar e zgjedhëm ish inxhinierin e diplomum Xhafer Nulin, që e falenderoj publikisht për sfidat edhe problemet edhe represionin që e ka pasë atë kohë. Nuk u kanë lehtë edhe pas viteve të ‘90-ta atë detyrë me kry, që e ka kry me, me një ndërgjegje të plotë, me një lëvizje kombëtare që bashkarisht kena punu... se jena nda tanishi në regjione. Sindikata ka operu domethanë në të gjitha pjesët që ka pasë minatorë, edhe në Mitrovicë, edhe në Skenderaj, edhe në Vushtrri, edhe në regjione të tjera kena qenë unifikues edhe i kena kordinu punët kush detyrat çka me punu.

Atëhere tema kryesore u kanë se shumica e minatorëve metën pa punë, realisht, edhe gjendja ekonomike ju vështirësu. Edhe unë i falenderoj, po flas në realitet, të gjithë popullatën e Kosovës, në veçanti Rrafshin e Dukagjinit, që ka marrë një hap atëherë po flas nashta hapi ma i madh që ka qenë histori, “Familja ndihmon Familjen”. Edhe na kanë mbështet ata, gjë që shumicën e minatorëve i kanë majtë. Unë duhet t’i falenderoj edhe Preshevën, Medvegjën e Bujanocin, që na kanë qenë gjithmonë në mbështetje. Na kanë dhanë ndihma, lloj-lloj ndihma i kena marrë. Me miell e me sheqer e, me vajra e me krejt domethanë na kanë siguru shumë. Po gjithmonë duhet me falenderu edhe diasporën në këtë rast, se edhe diaspora na kanë ndihmue financiarisht me mbajtë na minatorët.

Se esenca u kanë mos me ju nënshtru minatorët okupatorit serb, ajo ka qenë esenca që sindikata që duhet me iu falenderu sindikatës, ajo ka qenë promotore që e ka majtë këtë lidhje. Kry me Xhafer Nulin, po edhe të gjithë minatorët e tjerë që kanë dhanë kontribute të tilla.

Anita Susuri: Cili ka qenë angazhimi juaj konkret nëpër këto sindikata?

Shyqyri Sadiku: Angazhimi jem ka qenë në regjionin e Vushtrrisë. Kom qenë anëtar i kryesisë së sindikatës që kom operu tanë kohën “Familja ndihmon Familjen” edhe kena nda mjete për familjet skamnore. Po qendrën e kena pasë në Mitrovicë, e kena pasë edhe... U kanë një kryetar, Behgjet Aliu, që ka dhanë edhe ai kontribut, i ndjeri pas lufte ka vdek. Me të kena bashkpunue, nuk u kanë lehtë as në atë kohë me operue realisht edhe m’u organizu, kena organizu edhe takime edhe tubime sindikale, me minatorët. Po kena organizu takime të tilla nëpër xhamia, nëpër vene po flas ma të mshefta. Kena organizu edhe në shkolla. Sot është shkolla “Çajupi” në Vushtrri, që atëherë u kanë... nuk u kanë lehtë atëherë për drejtorin me na lshu objektin me majt përvjetorin e grevave që e majshëm. Ka qenë një organizim shumë i mirë.

Më kujtohet edhe... s’di cili vit ka qenë... realisht a ka qenë 80 e... ‘95 po më duket po, që u kanë pesë vjetori i grevës, gjashtë vjetori, a?

Anita Susuri: Mhm.

Shyqyri Sadiku: Edhe janë kanë të shtypme do pllakarta u kanë lokomotiva me minatorë. Realisht edhe kena organizu se u kanë pak problematik me i qitë ato pllakarta u dashke me i qitë nëpër objekte të ndryshme, po flas. Një iniciativë të tillë e kemi marrë bashkë me Xhafer Nulin, që gjithkush në

regjion të vet me i ngjitë. Janë kanë ekipet e ndame, tash po flas, në Vushtrri e kemi pasë obligim unë edhe ai Behgjet Aliu me ngjitë. Edhe aty më kujtohet si sot, ramazan u kanë, i kena ngjitë mas syfyri. Edhe nuk kena pasë atëherë diçka, lepak ose me lepitë po e kena marrë me beso, brum, në furrë e kena marrë me brum i kena ngjitë ato pllakarta nëpër Vushtrri krejt.

Anita Susuri: Çka ka shkru në pllakartë?

Shyqyri Sadiku: Pllakarta u kanë përvjetori i grevës edhe janë kanë po më doket viti i pestë a i gjashtë, kanë qenë gjashtë vagoneta dhe lokomotiva tu e tërhiqen minatorin. Po. Edhe nuk e di a e kom në shpi dikun, e kom ruajt një pllakartë të tillë nashta.

Anita Susuri: A e ki?

Shyqyri Sadiku: Nashta e kom. Rastësisht. Që muj e gjajë thashë. Ka qenë... po na i ka punue e ka pasë shtypshkronjën e ka pasë Nazmi Mikullovcit atëherë. Që e ka punu qatë... po idenë ja kena dhanë na, qysh me punu, po Nazmia ka qenë shtypshkronjën e ka pasë. Në Mitrovicë i kena punu, po ka pasë represion qaq të madh në atë ditë në mëngjes në Vushtrri, që me kanë ditë nashta në fund të fundit që ka represione qaq të tilla nuk kishum bo. U kanë e premtë atë ditë. Të premtën në mëngjes, natën e vendosëm, tashi m'u bo ni shtet-rrethim në Vushtrri krejt.

Edhe ka pasë thojshin edhe njerëz të malltretum, të rrahun edhe në forma të ndryshme kush i ka vendos. Po asnihere s'jena zbulu qe kena vendosë na ni gja të tillë, se ata gjithmonë bojshin thirrje gjoja që për ngritje. Ngritje të pakënaqësive të protestave të tilla. Edhe besoj që, po flas tash në kontekstin se kjo nuk është lavdatë e dikuj, por është lavdatë e ma së pari qytetarëve. Po flas edhe, jo veç Kosovës po edhe tu e falenderu edhe kombin shqiptar, që shumë kanë dhanë për Kosovë. Edhe kena arritë ku kena arritë.

Nuk po flas... tash duhet me i falenderu edhe lufta paqësore që ka qenë. Edhe duhet me kanë shumë të përkushtum që në vitet e '90-ta na ka prijë një njeri që ka pasë ideale, ka ditë me ru popullin e vet. Na nuk duhet me harru tash kontributin e Dr. Rugovës. Na kena pasë takime shumë të shpeshta si sindikatë me të, kena marrë instruksione nga ata. Por, gjithmonë kena punu ne kontekst që mos me i dëmtu njerzit. Qëllimi u kanë në atë kohë që mos me i dëmtu njerëzit. Na e pamë qe me luftë paqësore edhe me të tjera është vështirë me dalë.

Edhe fatbardhësisht filloi edhe lëvizjet e para që kanë qenë njerëzit, kanë qenë edhe për luftë të armatosur të pregaditë. Që tash në rast po flas që nuk na kanë lanë, iniciativë kena pasë na që me marrë... jena kanë ni grup që u kanë njëfarë Ramadan Nimani, jom kanë unë, u kanë njëfarë Musa, është i ndjeri, ka vdek e të tjera. Kena pasë një iniciativë me ardhë me minu një shtyllë të teleferikut, po mendoj të tensionit të lartë të "Trepçës". Se shkijet punojshin në atë kohë, e na s'punojshëm. Por, të drejtën me thanë, nuk na lanë.

Pengesat kanë qenë të tilla në politikë që bahet shumë e madhe. A na jena kanë të pregaditë, që kena pasë edhe eksploziv, të tillë në atë kohë që me i minue një shtyllë të tillë, që janë qito shtyllat e tensionit të lartë që mos me i lanë me punu, se ata fillunë edhe punën. Kanë qenë iniciativa të tilla, unë po thom ka edhe minatorë shumë, ja diku 42 a 43 të vramë në luftë. Minatorë që kanë qenë në punë këtu që ju kanë bashkangjitë edhe luftës realisht dhe kanë vdekë në luftë.

Por, ka edhe minatorë që kanë qenë, është ky Beqir Sahiti, s'di a keni pasë kontakt me të, ky ka qenë në këtë grupin e parë të Adem Jasharit, që jena kanë të kyçun na si grup i minatorëve, që ka qenë edhe është pregaditë për luftë në Shqipëri. Ka qenë grup i tillë i tyne që gjithmonë kena qenë në lëvizje, po flas.

Anita Susuri: E gjatë luftës a je kanë ti këtu?

Shyqyri Sadiku: Gjatë luftës krejt jom kanë në Kosovë. Krejt kohën në Kosovë domethënë nuk...

Anita Susuri: Qysh kanë kalu qato mujë?

Shyqyri Sadiku: Paj vështirë u kanë realisht, është një... vështirë se u kanë një luftë hakmarrëse. Tash ju e dini, tash se jeni gjeneratë e re realisht, ishalla s'i keni përjetu krejt po së paku s'duhet me i harru, u kanë një luftë, luftë, e pabarabartë po flas në atë kontekstin, se nuk kanë luftue ballë për ballë po gjithmonë janë hakmarrë në civilë, dhe pasojat gjithmonë i kanë marrë civilët. Filloi, po thom, lufta realisht, që u duftë nashta me fillu, se pa luftë, pa një iniciativë të tillë nashta nuk kishim mujtë me ardhë edhe ku jemi tash realisht. Po gjithmonë me përkrahjen e ndërkombtarëve, duhet m'i falenderu. Po lufta ka qenë vështirë se se u kanë luftë e pabarabartë edhe hakmarrja ka qenë te civilët.

Ka qenë represioni qaq i madh, qaq ka pasë lëvizje të popullatës, qaq ka pasë probleme të tilla, që me të vërtetë ka qenë vështirë me ja dalë, por duhet me iu falenderu më së pari Zotit, që disa familje me të vërtetë kanë pësuar shumë, disa kanë pshtue, disa kanë pagu shumë. Jonë shumë masakra që jonë ekzistuar, kanë ekzistuar realisht masakra të mëdhaja, kena pa raste realisht, unë po flas për veti që nuk ka ditë njeri a po pshton, a nuk po pshton. U kanë një luftë që, që po flas jonë hakmerrë në gra, fëmi domethënë luftë që ka qenë kundër civilëve. Jo luftë kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në njëfarë forme, po është orientu kah civilët ma shumë me u hakmerrë. Se nuk ka dashtë kta me pasë m'u ballafaqu në luftë direkte me, me Ushtrinë Çlirimtare, po...

Po thom, na duhet me kanë ma të lumtur... ata që kanë derdhë gjakun për Kosovë realisht, ata do të jenë në një histori të pashlyer të Kosovës. Ata që kanë dhanë kontribut për luftën, se luftën e kanë përkrah të gjithë. Pak a shumë, lufta gjithmonë zhvillohet me përkrahjen e qytetarëve, por gjithmonë është dikush në vijë të frontit me luftu. Po gjithmonë pa ndihmën e qytetarëve, a ndihmën e diasporës, pa ndihmën e ndërkombëtarëve na nuk kishem mujt me ardhë ku jem sot këtu.

Anita Susuri: E qysh ke marrë vendim që mos me u largu, me nejt gjatë luftës në Kosovë?

Shyqyri Sadiku: Qaso bindje kom pasë realisht në krye tem po flas, realisht që nuk kam dashtë me u largu prej Kosove kurrë. Kom pasë oferta une kur na kanë largu në vitet e '90-ta prej pune, une kom pasë oferta me shku edhe me jetu edhe jashtë. Me shku se dokumentacionet kush u shku prej “Trepçës”, që u kanë punëtor i “Trepçës” të gjithë i kanë marrë letrat si azilantë, i kanë pranuar, të gjitha shtetet po flas të Evropës.

Po nuk e kom pasë atë ideal, atë ide me ikë, me lshu Kosovën, se gjithmonë kom thanë s’paku me dhanë ni kontribut pak ma t’vogël mrena. Se ideja jonë u kanë me ardhë sot ku jemi, ni shtet me bo t’pavarun realisht. Qajo ka qenë ideali jem, po flas gjithmonë që nuk kom pasë qef as nihere kurrë me lshu Kosovën.

Anita Susuri: A ka pasë gjatë luftës naj rrezik që keni qenë shumë keq?

Shyqyri Sadiku: Po kena pasë rreziqe, po. Ka qenë ofenziva kur ka qenë në Kçiq. Kur ajo ofenzivë ka qenë edhe në pjesën e sundimit që e ka rrokë krejt regjionin e Shalës. Une nuk e di ma rrezik ku ki me kanë kur je me anëtarë t’familjës, me nanë. Po flas se vllaznia jonë kanë krejt jashtë, i vetmi jom kanë une mrena në Kosovë n’kohë t’luftës. E kom pasë nanën obligim, e kom pasë motrën, e kom pasë grunë e vllaut me fëmijë, e kom pasë grunë më fëmijë. Domethanë qata anëtarë...

U kanë shumë vështirë kur ka qenë ofenziva që u zhdergjë në Kçiq, jena kanë në Kçiq, ka qenë represion i paparë. Aty jonë zhdergjë prej s’nalti, ajo ka qenë tmerri ma i madh. Ti nuk e dishe ku po shkon, a çka po bon. Edhe shumica të tillë e njerëzve u kanë kjo pjesa mbi burgun e Smrekovnicës, që shumicën e njerëzve i kanë ulë aty, atë. Gjithë natën i kanë majtë represioni serb tu i rreh, tu i shantazhu, tu i këcnu. Shumicën t’mashkujve i kanë marrë i kanë burgosë, i kanë shti në burg të Smrekovnicës.

Ni pjesë të tjerë çka jonë metë edhe t’pjesës të Kçiqit edhe Smrekovnicës edhe fshatrat tjera, i kanë largu nëpër traktora qysh kanë qenë edhe i kanë drejtu për Shqipni, krejt i kanë... une fati jonë po flas, atë ditë kena qenë në ni lagje të Kçiqit, s’kena lëvizë, s’kena lëvizë. U nisë kolona realisht me dalë, me shku për Shqipni, s’kena lëvizë edhe jena metë në Kçiq. Kom metë ni kohë në Kçiq.

Tanishi fillunë qat ditë, u kanë po m’doket e dille ajo ditë që ka qenë masakra Studime, edhe atje ka qenë ni masakër shumë e ranë, edhe fillunë tash njerëzit që i njoftim me ardhë, prej Studime erdhën në Kçiq. Edhe na kallxun për masakrat e rana që kanë ndodhë atje. Ekzekutime domethanë t’ndryshme, që kena pasë edhe njerëz t’njoftim që jonë ekzekutue, kusheri të Bares e sene. Po u dufke me i tejkalu situata t’tilla, po na u dufke me ju ofru ndihmë atyne se ata kishin kalu edhe ma vështirë se na, se atyne ja kishin ekzekutu djalin në sy.

Tash na duhet me ju ofru ndihmë atyne edhe kena qëndru, po flas kom qëndru për pak ni kohë në Kçiq. Tanishi u ngulfat realisht prej refugjatëve shumë që erdhen, se isha te motra, te motra kom nejt gjatë luftës ni kohë në Kçiq. Tanishi kom lëvizë prej Kçiqi me shku në Bajskë, afër Smrekovnicës osht’

që aty ka pasë edhe serbë t'banum. Jom shku kom lëvizë aty, kom qëndru edhe aty ni kohë dej ka përfundu lufta.

Kanë qenë ditë t'vështiran po flas. Ktu jonë kanë policia edhe ushtria kanë qenë te burgu. Na bojshim lëvizjet zakonisht natën realisht, se u dufke me siguru edhe ushqim, se u kanë vështirë, u kanë problem edhe ushqim me siguru n'atë kohë. Por, po flas, fatbardhësisht ndihmën na dha ma t'madhe edhe NATO që ndërhyti. Ajo nashta edhe ka qenë promotori kryesor që i ka shpejtu procedurat me ardhë deri ktu. Se na, t'ndodhke edhe pak realisht na jena kanë nifarë formë të, të dorëzum në të gjitha format, se ushqim kur s'kie, ti je i dorëzum.

Edhe jonë kanë ditë të shtira, drejtën me t'thanë jonë kanë ditë të shtira me ju siguru fëmijëve ushqim, nuk u kanë bash lehtë. Po flas, nashta ma ka përsëritë atë kohën e fëmijërisë që hongshum edhe misër. Se për patate shkojshum, natën po flas, shkojshum në Doborllukë. Së Doborllukën, i qitën krejt fshatin Doborllukë, i shpërngulën për Shqipëri. Edhe pjesën te na ku jena kanë, pjesën ku banoj në Vushtrri kur na kanë ni... se krejt i kanë qitë.

Jonë hi me polici, qitshin armë me na përndjekë, me na largu, atë pjesë tonën e kanë çu për Maqedoni. Po une t'drejtën me t'thanë kom hezitu me marrë ni rrugë të tillë, edhe une jom ikë jom ardhë në Kçiq te motra. Tanishi kom lëvizë apet në Vushtrri ni kohë, po apet fillunë represionet në Vushtrri. Fillunë ni pjesë aty ja nisën edhe natën policia ja nisën i masakrojshin, që u kanë edhe ky baba i mjekut, Faik Bllatës, që e kanë pa masakru natën n'shpi. Edhe tanishi u detyrumë me mixhë prapë me lëvizë, apet erdhëm në Kçiq. Edhe qishtu ka përfundu historia e luftës po flas.

Anita Susuri: Qysh e pritët çlirimin, lajmin?

Shyqyri Sadiku: Lajmin realisht ka qenë nashta, po flas lindja e dytë për neve po flas. Na çka metëm në Kosovë përfundimisht edhe nifarë forme jena kanë edhe n'forma t'ndryshme edhe t'dorëzum realisht. Veç pritshëm forcat kur po hinë edhe i pushkatojnë, alternativë tjetër, rrugë s'kena pasë. Rrugët jonë kanë krejt t'bllokume, t'mbyllne. Plus qe ja nisën tani me marrë kjo pjesa serbe, u dufke me shku m'u lajmëru, njerëzit qe jonë në Kosovë me marrë nifarë kartoni t'gjelbërt, me u lajmëru.

Por, realisht une s'jom shku me marrë. Asnihere s'jom pajtu me atë farë forme, kom thanë, "N'fund t'fundit nuk po du me shku n'dorë t'atina". Nashta kanë pasë edhe t'dhana realisht kanë mujtë... edhe shumë njerëz kanë pësuar qat farë forme. Jonë shku me marrë kartonin ma s'jonë kthy, i kanë ekzekutu. S'kom qenë pjesë e saj edhe s'jom shku realisht me marrë.

Edhe po flas që hyrjen e NATO-s, nashta po flas edhe ni here ka qenë lindje e dytë për neve. Edhe hyrjen e NATO-s nuk e kena ditë saktësisht kur ka me hy realisht trupat, po i kena pa helikopterat. Unë jom kanë në fshatin e Bajës kur i kena pa francezët qe jonë lshue në Vushtrri. Ku osht' qikjo "Ina" tash, që po bohët rrethi i dytë knena, n'dalje, qe dahet rruga me hi për Vushtrri, edhe shkon për Prishtinë, u

kanë qajo pjesa nalt e pabanume, qaty jonë lshu ekipa e parë e kombsorisë franceze. Me helikoptera i kanë lshu.

Edhe tanishi kanë fillu me lëvizë në pozicione ku kanë qenë serbët, ushtria franceze. Edhe atëhere e kena ndi ni frymë të lirisë, realisht po flas, edhe atëhere kena nisë me lëvizë. Une me datën, po m'duket me datën 17 kanë hy francezët në Vushtrri, data 17 qershor ka qenë. Une me 18 qershor jom shku n'shpi. I kom marrë familjen realisht jom shku. Kur jom shku n'shpi me t'vërtetë menxi i kom çelë dyrtë e oborrit prej barit, prej seneve, domethanë si pa njerëz ka jetu.

Po nashta ka qenë lindja e dytë për neve që ka pasë qaq gëzim, qaq pritje t'mirë e kanë pritë qytetarët hyrjen e KFOR-it. Ka pasë njerëz që jonë përkulë para KFOR-it, po flas edhe këpucat ja u kanë puthë se nashta u kanë lindja e dytë për neve po flas. Se na nifare forme u pajtumë që na s'kem me ekzistuar realisht si familje ma. Se ndodhshin maskara të tilla, po ndodhi kjo mrekulli po thom edhe sot jem ku jem. Ka qenë nashta po flas ni histori e gjatë. Po çka po m'brengosë ma s'shumti tash, po m'brengosë që s'po punojmë. Kjo osht' ma e keqja që shumë pak jonë t'u punue, po flas tu u nisë prej institucioneve t'shtetit edhe deri n'nivelin ma t'ulët, se tanë majnë përgjegjësi ka pak.

Anita Susuri: Deshta me ju pytë tash mas luftës, kur keni ardhë për herë t'parë në "Trepçë" me vazhdu punën?

Shyqyri Sadiku: Po ekipa e parë ka fillu me 22 dhjetor '99.

Anita Susuri: Edhe pse ka fillu qaq vonë për shembull? Prej qershorit kur osht' shliku Kosova, pse...

Shyqyri Sadiku: Po deri n'qatë kohë domethanë kanë qenë të përqendruara nashta, tash po flas edhe KFOR-i ka pasë ni gja të tillë, ka pasë nashta edhe hile KFOR-i n'këtë pjesën e "Trepçës" realisht që e kanë punu serbët. Ktu jonë kanë t'u punu serbët. Realisht edhe gjatë asaj periudhe, gjatë asaj kohë kanë punu serbët. Edhe pas, po flas pas hyrjes t'trupavë të NATO-s në qershor deri n'dhjetor s'kena mujtë na me ardhë ktu për arsye të shumta po flas, që i ka mbrojtë KFOR-i realisht.

Anita Susuri: Po, domethanë mas luftës kur keni ardhë qysh jeni kthy n'punë edhe në çfarë gjendje e keni gjetë minierën?

Shyqyri Sadiku: Po maslufte na jemi mundu ma herët m'u kthy n'punë, po realisht nuk na ka leju nifare forme edhe KFOR-i me ardhë m kthy në vendet tona t'punës. Na kena mendu që kemi m'u kthy t'gjithë n'punë se qashtu ka qenë marrëveshja, një për t'gjithë, t'gjithë për një. Nuk osht' dhanë ajo mundësi edhe na u duftë prapë me protesta, me bllokimin e rrugëve n'tunell e sene me u kthy n'punë.

Kur e kanë pa edhe KFOR-i që jem serioz n'kërkesat tona me u kthy n'punë realisht atëhere osht' leju, osht' bo nifare marrëveshje... se atëhere "Trepçën" e ka menaxhu UNMIK-u. U metë si ndërmarrje

shoqërore që e ka menaxhu UNMIK-u edhe osht' bo ni marrëveshje në mes UNMIK-ut edhe ish menaxhmentit të "Trepçës" atëhere, Burhanit e tjerë, që fillimisht me fillu punën dyqind ekspertë të minierës.

Po të gjithë që jena kanë, si ekspertë që jena thirrë po flas, që jena kanë dyqind vetë u duftë me nënshkrue që me vetëdëshirë, me vetiniciativë po hin, që kërkush nuk merr përgjegjësi çka ndodhë mrena për mrena në minierë. Edhe e kena pasë vullnetin aq t'madh që e kena nënshkru të gjithë që me vetëdëshirë, pa asnjë përgjegjësi ndaj kërkujt s'kemi lypë, por po dojna m'u kthy n'punë realisht... edhe qëllimi ka qenë i atynë dyqind ekspertave me ardhë, edhe realisht kena arritë qëllimin, jena ardhë, kena fillu.

E kena gjetë ni gjendje t'mjerume realisht. Krejt kto zyre kanë qenë të demolume. Mos t'flas banjo e demolume, dokumentacioni i shpërndamë, i gjumë. Miniera ka qenë e mbyllne, kanë qenë dikun ni milion kubik ujë të tubume. Horizonti i nimdhetë ka qenë i zhytun n'ujë krejt. Edhe falë atyne eksperteve, atyne njerëzve që kanë punu n'atë kohë kena arritë diçka me bo realisht. Te tanë jena kanë papagesë, kena punu gratis. As s'kena pasë banjo, as s'kena pasë ushqim, as kurgjo. Krejt kto i kena siguru nihere, nga shpija ushqimin edhe transportin, edhe pastrimin e kena bo n'shpi.

Dikur u organizun banorët e lagjës në Stantërg edhe na kanë ushqy ni kohë, na kanë pru ushqimin. Edhe kena fillu ai grup, që e falenderoj t'gjithë atë grup që kanë kriju kushte ma t'mira. Se u kanë rrezik miniera m'u fundosë krejt, se pompat e ujit që thithin ujë, se dikun thithin ujë... 3000 deri 3500 metër kub n'minut ka rrjedhje t'ujit... edhe nuk funksionojshin. Falë ekipit t'ekspertëve që e kena pasë me pompa, kena fillu me i aktivizu pompat.

Edhe rreziku ma i madh u kanë që na ka dalë ujë n'horizontin e dhetë. Edhe falë atyne ekspertave realisht... filloi me na dalë ujë n'horizontin e dhetë. Me daljën e ujit n'horizontin e dhetë miniera u fundoske. Atëhere po flas e menaxhojke KFOR-i, ka qenë edhe një pjesë e KFOR-it i informum që miniera osht' në rrezik. Beso nuk kanë pasë asni shqetësim ata rreth ktina problemi edhe u kanë ni komandant, nifarë Rajahard, a Rajden a, u kanë gjerman. Edhe i thamë, "Po na fundosët miniera". Tha, "Punojnë gjykatat merren me këtë punë në t'ardhmën".

Na e pamë që problemi vështirësitë, kena marrë iniciativë vet, e kena blloku horizontin e dhetë, i kena betonu. I kena mbyllë korrioder atje tunelin, edhe e kena shpëtu minierën. Atëhere i kena aktivizu, me ekipin që e kena pasë profesional, pompat me largimin e ujit. Edhe gradualisht kena nisë, kadal, kadal edhe e kena kthy n'gjendje t'normalizimit minierën. Na u ka duftë ni kohë koxha e gatë, dikun dej në 2005 kena punu realisht veç në mirëmbajtje edhe pastrimin e minierës, që kena arritë me thithë t'gjithë ata ujë.

Përmi ni milion kub ujë e kena qitë jashtë miniere. Edhe e kena hapë herën, se osht' dera mbyllë n'horizontin e nimdhetë. Edhe e kena hapë rrugën për me fillu prodhimin. Prodhimi testues ka fillu në

vitin 2005, që gjithmonë po flas fatkeqësisht që minatorët nuk kanë mujtë me u kthyer t'gjithë n'punë. Kjo ka qenë goditja nashta ma e ranë pas lufte për minatorët, që shumica s'kanë mujtë edhe jonë metë shumica rrugëve. Edhe sot ki minatorë që bredhin rrugëve.

Une e kom thanë edhe publikisht që osht' fatkeqësia ma e madhe që sot minatorët e "Trepçës" shkojnë edhe në kanta t'bërlllogut marrin për me siguru ushqimin e familjës edhe fëmive. Edhe kta politikajt tanë s'lodhën hiç, absolutikisht s'lodhën për këtë punë. Fjalë gjatë fushatave ki sa dushë, e konkretisht realizim prej tyre s'kie. Edhe për qata po thom mas 20 viteve une si individ, po flas personalisht për veti, jom i zhgënjymë. Jom i zhgënjymë, jo për ata çka kom bo, se me ata mburrem, edhe po flas prapë duhet me i falenderu ata që e kanë derdhë gjakun për Kosovën, na jem ku jem.

Po me politikën aktuale prej mas lufte në Kosovë jom i zhgënjymë. Shumë pak kanë punue për popullatë, e shumë kanë punu për xhepa t'veta. Edhe kjo osht' dhimbja ma e madhe që m'dhimën, edhe sot minatorët jonë të detyrum me dalë në pension... jo me pension realisht, po flas pension del, po del pension si i papunë, del me 90 euro. Po flas ky osht' turpi ma i madh që na ka ndodhë najhere në histori po flas. Ky osht' turp. Për ni politikan edhe njerëz që e udhëheqin politikën në Kosovë, ky osht' turpi ma i madh me na ndodhë, minatorët me na shku n'pension t'papunë.

Njejtë e ka tretmanin sikur ai që s'ka punu kurrë, si minatori që kanë dhanë ni kontribut. E ka fliju vetën, e ka fliju familjën, ka dhanë gjithçka për Kosovë edhe sot nuk e ka asni mbështetje. S'ka asni ligj për minatorë. Me vite të tëra shkojmë n'takime të tilla, po flas n'kuadër që jom kanë kryetar sindikate në vitin 2016-2019, e kom ngritë zërin, kom bo boll shumë, kena bo edhe protesta, kena bo edhe greva. Gjithmonë na kanë premtu, realizimi osht' zero.

Nuk ka n'këtë drejtim, nuk osht' punu edhe mu po m'vjen shumë keq që sot jem në situatë të tillë, në situatë të ranë. Minatorët me bredhë rrugëve, mos me pasë asni mbështetje prej ktij shteti. Që këtë shtet, ky shtet i ka bash minatorëve, s'paku minatorëve u ka borxh, qasaj gjenerate i ka borxh. Se qajo gjeneratë ka fillue nashta edhe hapat e parë po flas, të shtetit kanë fillu qitu në Stantërg. I kanë pasë s'pakti borxh për kta minatorë që kanë qenë pjesë e tyre me i trajtu pak ma mirë, jo n'këtë gjendje. Une s'po thom me i çu të t'parët atje. Po me i trajtu, me ja u bo ni ligj t'pensioneve, me i çu...

Sot jonë t'detyrum minatorët n'moshën 64 vjeçare, 65 vjeçare me punu në minierë. Ky osht' krim, beso nuk ka kun n'botë, n'regjion që aplikohet kjo praktikë, minatori 64 vjet me punu në minierë. Ky osht' shqetësimi im, për qata une po flas personalisht për veti, jom shumë i zhgënjymë me qasjën, me politikën, pe politikajt në Kosovë qysh po i trajtojnë. Jo veç minatorët, po t'gjitha nivelet.

Une besoj që me kanë t'përkushtum, me punue për shtet e jo për pushtet i kishim punët ma mirë. Na duhet me punu ta forcojmë shtetin, ta edukojmë rininë edhe t'ia dhajmë rinisë. Rinia osht' ajo që osht' e ardhmja e ni shteti. Rinia duhet me marrë tash situatën n'dorë. Na epoka jonë ka kalue, e kena kry

misionin. Une realisht me kanë mbarë e mirë isha n'penzion. Ish sistemi po flas, n'sistemin jugosllav une që dhetë vitë isha n'penzion.

Sot m'duhet n'kit moshë me ardhë, n'kit moshë duhet me ardhë me dhanë kontributin m'u merr me prodhim, me çështje t'prodhimit. Gjithmonë prodhimin osht' ai që jep kontribut osht' rinia, gjenerata e re. Ata munën m'u ballafaqu me probleme, me të tjera. Na mujna me kanë këshilldhënës n'kit aspekt, me ju dhanë këshilla, me ju dhanë... për pune. Se tjera... jo na me kanë nashta promotor të prodhimit. Çka pritet prej minatorit 64 vjet me dhanë n'prodhim?

Shumica fatkeqësisht nuk e presin penzionin hiç, vdesin n'marrëdhanje pune qe e kem, ajo osht' fatkeqësia ma e madhe, po na vdesin njerëzit dhe nuk ka asni përkuqdesje nga shteti familja, hiç. Vdes n'marrëdhanje punë minatori, s'ka përkuqdesje. Kto jonë shqetësimet, kto jonë brengat e mija dhe domethanë... për kto situata të tilla, beso qiky osht' shqetësimi im ma i madh, dhe nashta po flas n'atë aspektin edhe pej, pej pakënaqësive që i kem të tilla.

S'kisha besu, une personalisht po flas për veti nuk kisha besu që kem me ardhë na n'qit situatë të tillë. Por, po shpresojmë ishalla ka ditë ma t'mira, vijnë njerëz me t'vërtetë që e dojnë këtë Kosovë edhe që e zhvillojnë, edhe këtë rini e nalin, nuk e lajnë me dalë jashtë. Osht' shumë dhimbje e madhe sot me shkollu fëminë, me krejt obligimet që i kie, me ta kry fakulltetin edhe me ja u çu n'shtetet Evropiane t'përgaditë me ja lanë. Kjo osht' dhimbja edhe humbja jonë ma e madhe. Na po investojmë, na po e shkollojmë, ti po ja çon t'përgaditë po ja le ni shteti atje në Evropë. Në vend se me dhanë naj kontribut mrena në Kosovë, na po e çojmë t'përgaditë, po e hupim, po e hupim rininë, po e mbytëm shpresën tonë. Nuk e di, nëse vazhdon qishtu Kosova, nuk e di çka i vynë kërkuj.

Anita Susuri: Zoti Shyqyri, faleminderit shumë!

Shyqyri Sadiku: Faleminderës edhe prej juve, ishte kënaqësi!